

TRI PARIMET

Shejhul Islam Muhammed Ibn Abdul-Dahab

*Me Komentin nga
Shejkh Abdul-Aziz Ibn Baz (Rahimehulla)*



Tri Parimet Themelore¹:

Dije Allahu të mëshiroftë se e kemi obligim mësimin e katër çështjeve²:

Ë para është dituria³, e cila është:

¹ Kjo është një broshurë e rëndësishme rreth Akijdes, të cilën e shkroi Shejkhu Ebu 'Abdullah, el-Imam Muhamed Ibn 'Abdul-Uehab Ibn Sulejman Ibn 'Ali et-Temijmi el-Hanbelij, Imami i famshëm, Ringjallësi i gjurmëve të Islamit të cilat u fshinë gjatë gjysmës së dytë të shekullit të dymbëdhjetë, Allahu e mëshiroftë dhe ia bëftë të këndshëm vendbanimin. Ai - Allahu e mëshiroftë - ua mësonte këto parime nxënësave të dijes dhe popullit të thjeshtë që t'i mësonin përmendësh dhe që të rrenjoseshin në zemrat e tyre ngase ato janë prej parimeve të Akijdes. Ai vdiq në vitin 1206 Hixhrij, ndërsa lindi në vitin 1115 Hixhrij. Pra, ai jetoi nëntëdhjetë e një vite. Jeta e tij që e mbushur përplot me bamirësi dhe thirrje për tek Allahu, duke dhënë mësim e udhëzim dhe duke bërë durim përgjatë kësaj veprimtarie. Nëpërmjet tij Allahu shpëtoi robërit dhe vendin në kohën kur ka jetuar, në këtë Gadishull. Thirrja e tij u përhap gjithashtu edhe jashtë Gadishullit (Arabik), që nga Shami, Egjipti, Iraku, India etj, si rezultat i thirrësave që morën dijen prej tij dhe pastaj shkuan në ato vende e shtete, dhe si rezultat i letrave dhe librave të tij që u përhapën nga ai dhe nga pasuesit, përkrahësit dhe thirrësat që ndiqnin thirrjen e tij për tek Allahu.

² Është obligim për Besimtarin dhe Besimtare, të voglin e të madhin, që t'i mësojë këto çështje.

³ Pra, njeriu e ka obligim që të ketë dije dhe të meditojë derisa të jetë i qartë dhe të njohë Fenë e Allahut, i Cili e krijoi atë pikërisht për këtë gjë. Kjo dije është njohja e Allahut, njohja e Pejgamberit të Tij dhe njohja e Fesë Islame me argumente. Dhe kjo është gjëja e parë rreth të cilës mediton robi: kush është Zoti i tij? Kështu, ai e mëson që Zoti i Tij është Krijuesi që e ka krijuar, e ka furnizuar dhe i ka dhënë atij mirësi, Ai që ka krijuar të tjerët para tij dhe krijon ata që do të vijnë pas tij; Ai është Zoti i gjithçkaje që egziston dhe, vërtet, Ai është i Adhuruari me të drejtë, pos të Cilit askush nuk e meriton adhurimin, kurrën e kurrës, as ndonjë melek (ëngjëll) i afërt tek Ai, as ndonjë profet i dërguar, as ndonjë xhind, njeri, bust apo çdo gjë tjetër. Zaten,

- a) njohja e Allahut,
- b) njohja e Pejgamberit⁴ të Tij
- c) dhe njohja e Fesë Islame me argumente.

Ë dyta është: të punuarit me të.⁵

adhurimi i takon vetëm Allahut dhe Ai është i Adhuruari me hak dhe Ai meriton që të adhurohet. Dhe Ai është Zoti i gjithçkaje që egziston, Ai është Zoti yt dhe i Adhuruari yt me hak, i pastër dhe i lartësuar nga çdo e metë është Ai. Prandaj mësoje këtë çështjen e parë, e cila është: të njohësh Zotin tënd, të njohësh Pejgamberin tënd dhe të njohësh Fenë tënde me argumente, “ka thënë Allahu” dhe ka thënë i Dërguari”, e jo me opinione apo me fjalën e filanit, porse me argumente nga ajetet dhe hadithet. Dhe kjo është feja Islame në të cilën ti je i urdhëruar që të hysh dhe t’i përmbahesh saj. Dhe Islami është adhurimi i Allahut. Ka thënë i Përsosuri e i Lartësuar nga çdo e metë për adhurimin: **“Dhe Unë nuk i kam krijuar xhindët dhe njerëzit përveç se që të më adhurojnë Mua.”** Ky adhurim është Islami. Ai është bindje ndaj Allahut dhe ndaj të Dëguarit të Tij, është zbatim i urdhërave të Allahut dhe braktisje e harrameve (ndalesave) që ka vendosur Ai. Ky është adhurimi për të cilin u krijuan njerëzit. Ai urdhëroi ata me Fjalën e Tij që t’ia përkushtojnë adhurimin Atij: **“O ju njerëz adhuroni Zotin tuaj!”** Domethënë, adhurojeni Atë duke iu bindur urdhërave të Tij, duke qëndruar larg ndalesave që ka vendosur Ai, duke nënshtruar fytyrën për Të dhe duke e veçuar me adhurim Allahun e Përsosur e të Lartësuar nga çdo e metë.

⁴ E prej saj është që ta njohësh Profetin tënd, i cili është Muhamed Ibn ‘Abdullahut Ibn ‘Abdul-Mutalib el-Hashimij el-Kureshij el-Mekki, pastaj el-Medenij, lavdërimi dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të. Pra, ta mësosh që ai është Pejgamberi yt dhe se Allahu e dërgoi atë tek ty me Fenë e Vërtetë, që të të mësojë e të të udhëzojë ty, prandaj beso që ai është i Dërguari i Allahut me të vërtetë dhe se Allahu e dërgoi atë për të gjitha krijesat nga xhindët dhe njerëzit; dhe se është obligim pasimi i tij dhe ecja në rrugën e tij. Do të vijë më mbas një sqarim i detajuar për këtë tek parimi i tretë.

⁵ Domethënë, që të punohet me këtë Fe, me namazin, agjërimin, xhihadin, haxhin, besimin dhe devotshmërinë. Pra, që të punojë me Islamin pasi robi është krijuar për këtë, është i krijuar për adhurimin e Allahut. Kështu që, ti e ke detyrë që të mësosh dhe të punosh me këtë Fe dhe ta adhurosh Allahun të vetëm, të falësh namazin, të japësh zekatin, të agjërosh Ramadanin, të bësh

Ë treta: të thërrasësh tek kjo.⁶

Ë katërta: të durosh dëmtimet që has gjatë kësaj.⁷

haxhin në Qabe, të besosh në Allahun, në Melaiket e Tij, në të Dërguarit dhe Librat e Tij, në Ditën e Gjykimit, në Kaderin dhe të mirën e të keqen që vjen me të, si dhe të urdhërosh të mirën e të ndalosh të keqen, të jesh bamirës me prindërit, të mbash lidhjet me farefisin, si dhe vepra të tjera. Pra, të punosh me atë që të ka urdhëruar Allahu dhe të përmbahesh nga ajo që të ka ndaluar Allahu, t'i lësh gjynahet të cilat janë të ndaluara për ty dhe të bësh detyrat me të cilat je urdhëruar.

⁶ Domethënë, të thërrasësh tek kjo Fe e t'i këshillosh njerëzit që t'i përmbahen asaj, t'i udhëzosh, t'i urdhërosh për të mira e t'i ndalosh nga të këqijat, kjo është thirrja në Fenë Islame. Andaj, çdo Musliman e ka detyrë që të thërrasë tek Allahu sipas mundësisë dhe dijes së tij. Pra gjithësecili, burrë apo grua, duhet të marrë përsipër një pjesë nga detyra e përcjelljes së thirrjes, përcjelljes së udhëzimit dhe këshillës, si dhe të thërrasë në Teuhidin e Allahut, të thërrasë në namaz dhe në faljen e tij rregullisht, në dhënien e Zekatit, në agjërimin e Ramadanit, në kryerjen e Haxhit për këdo që ka mundësi, në bamirësinë ndaj prindërve, në mbajtjen e lidhjeve të gjakut dhe në braktisjen e të gjitha gjynaheve.

⁷ Domethënë, të durojë dëmtimet që përjeton gjatë gjithë kësaj, ngase njeriu mund të dëmtohet, mund të lodhet nga ai të cilin po e thërret., ose nga dikush tjetër, ose nga familja e tij apo nga njerëz të tjerë. Kështu që, është detyrë që të durohet dhe të shpresohet shpërblimi tek Allahu. Pra, besimtari bën durim në besimin që ka në Allahun dhe bën durim në punimin me atë që e ka urdhëruar Allahu dhe lënien e asaj që e ka ndaluar Allahu, si dhe bën durim në thirrjen tek Allahu, në mësimdhënie dhe në urdhërimin e të mirës dhe ndalimin e të keqes. Andaj, doemos që duhet bërë durim në të gjitha këto çështje, pasi e gjithë Feja kërkon durim; durim në thirrjen tek Allahu i Vetëm, durim në faljen e namazit, në dhënien e zekatit, në agjërim, në kryerjen e haxhit, në urdhërimin e të mirës dhe ndalimin e të keqes, durim në përmbajtjen nga haramet dhe të këqijat dhe durimin në paralajmërimin e të tjerëve që të mos u afrohen atyre. Dhe nëse njeriu nuk bën durim, ai do të bjerë në atë që ia ka ndaluar Allahu ose do të lërë atë që ia ka urdhëruar Allahu. Prandaj i Lartësuar i ka thënë të Dërguarit të Tij: **“Prandaj, ti bëhu i durueshëm, ashtu siç kanë duruar me këmbëngulje të Dërguarit e**

Dhe argumenti është Fjala e të Lartësuarit:

﴿وَالْعَصْرُ﴾ إِنَّ الْإِنْسَانَ لِرَبِّهِ لَكْفُورٌ ﴿١﴾ إِلَّا الَّذِينَ ءَامَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ وَتَوَّصُوا
بِالْحَقِّ وَتَوَّصُوا بِالصَّبْرِ ﴿٢﴾﴾

"Pasha kohën! Me të vërtetë njeriu është në humbje të sigurtë. Me përjashtim të atyre që besuan dhe bënë vepra të mira, si dhe këshilluan njëri-tjetrin me të vërtetën dhe këshilluan njëri-tjetrin me durimin." [el-Åsr, 1-3]⁸

vendosur." [el-Ahkaf, 35] Dhe ka thënë i Përsosuri nga çdo e metë: "Prandaj, duro për gjykimin e Zotit tënd se, me të vërtetë, ti je nën Sytë Tanë!" [et-Tur, 48] Dhe ka thënë i Lartësuarit: "Prandaj duro! Durimi yt është vetëm me ndihmën e Allahut." [en-Nahl, 127] Dhe ka thënë i Lartësuarit: "Vërtet, vetëm ata që janë të durueshëm, do të shpërblehen pa masë." [ez-Zumer, 10] Dhe ka thënë i Lartësuarit: "Andaj duroni! S'ka dyshim se Allahu është me durimtarët." [el-Enfal, 46] Domethënë: duroni në bindjen ndaj Allahut dhe në lënien e mosbindjes ndaj Tij, si dhe kini kujdes urdhërin e Tij dhe rënien në ndalesat që Ai u ka vendosur.

⁸ Dhe ky është argumenti për këto katër çështje. Tek kjo sure madhështore është argumenti i këtyre çështjeve dhe kjo është e gjithë Feja, ngase e gjithë Feja është besim, vepër, thirrje dhe durim; besim në të vërtetën, veprim sipas saj, thirrje drejt saj dhe durim gjatë dëmtimeve që has në të gjitha këto. Dhe njerëzit që të gjithë janë në humbje: **"Me përjashtim të atyre që besuan dhe bënë vepra të mira..."** e gjer në fund të ajetit. Domethënë, këta janë ata të cilët i ka kursyer Allahu nga humbja. Pra, të gjithë bijtë e Ademit janë në humbje dhe në rrugën e shkatërrimit, me përjashtim të atyre që besuan dhe bënë vepra të mira, si dhe këshilluan njëri-tjetrin me të vërtetën dhe këshilluan njëri-tjetrin me durimin, kështu që, ata janë të shpëtuarit dhe të lumturit. Dhe me të vërtetë Allahu u betua për këtë me Fjalën e Tij: **"Pasha kohën!"** Dhe Ai është që e thotë të vërtetën, i Përsosuri e i Lartësuarit nga çdo e metë, edhe nëqoftëse Ai nuk betohet, mirëpo Ai u betua për ta përforcuar atë që tha. Dhe Allahu *Subhanehu ue Te'ala* betohet në cilën do Ai nga krijesat e Tij dhe askush nuk e ndalon dot nga kjo. Ai është betuar në qiellin me yje, është betuar në qiellin dhe në yllin trokitës, në paraditen, në diellin dhe shkëlqimin e tij, në natën kur ajo mbulon me terr, në Melaiket që marrin shpirtërat, si dhe në gjëra të tjera, ngase krijesat tregojnë madhësinë e Tij

Ka thënë esh-Shafi’ij,⁹ Allahu i Ɣartësuar pastë mëshirë për të:

لَوْ مَا أَنْزَلَ اللَّهُ حُجَّةَ عَلَى خَلْقِهِ إِلَّا هَذِهِ السُّورَةَ لَكَفَّهُمْ.

“Sikur Allahu të mos kishte zbritur mbi krijesat argument tjetër pos kësaj sureje, ajo do t’u kishte mjaftuar.”¹⁰

dhe se i Përsosuri nga çdo e metë është Ai që e meriton adhurimin, dhe se ato bëjnë të qartë madhësitinë e krijimit të këtyre krijesave, të cilat tregojnë Teuhidin e Tij dhe se Ai i vetëm e meriton adhurimin. Por ama krijesës nuk i takon që të betohet në diçka tjetër përveç se në Zotin e tij. Kështu që, ai nuk betohet e përbetohet përveç se në Allahun, dhe nuk i lejohet që të betohet në pejgamberët, as në idhujt, as në njerëzit e devotshëm, as në besë, as në Qabe e as në ndonjë gjë tjetër. Kjo është detyra që ka Muslimani, në sajë të fjalës së Pejgamberit (*sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem*): “Kush betohet në diçka tjetër në vend të Allahut ka bërë shirk.” E ka tansmetuar Imam Ahmedi me zinxhir të saktë. Ai (*sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem*) ka thënë gjithashtu: “Kush do të betohet, le të betohet në Allahun, ose përndryshe të heshtë.” Pra, detyra e Muslimanit dhe e Muslimanes është që të ruhen e të kenë kujdes nga të betuarit në diçka tjetër pos Allahut, dhe të gjitha betimet e tyre të jenë vetëm në Allahun *Subhanehu ue Te’ala*.

⁹ Esh-Shafi’ij është Imami i famshëm, një prej dijetarëve të mëdhenj dhe një prej katër imamëve. Ai është Muhamed Ibn Idris esh-Shafi’ij el-Muttalibij, i lindur në vitin 150 Hixhrij dhe ka vdekur në vitin 204 Hixhrij.

¹⁰ Ai, Allahu e mëshiroftë, thotë: **“Sikur Allahu të mos kishte zbritur mbi krijesat argument tjetër pos kësaj sureje, ajo do t’u kishte mjaftuar.”** Domethënë, nëse ata do ta analizonin e do të meditoinin në të, ajo do të kishte qenë e mjaftueshme që ata t’i përmbaheshin të vërtetës, të zbatonin detyrat që ua ngarkoi Allahu dhe të qëndronin larg gjërave që Ai ua ndaloi, ngase Allahu e bëri të qartë se ata të cilët besuan dhe bënë vepra të mira, si dhe këshilluan njëri-tjetrin me të vërtetën dhe këshilluan njëri-tjetrin me durimin, ata janë të shpëtuarit, kurse çdokush tjetër pos atyre është i humbur. Dhe ky argument dëshmon obligueshmërinë e porosisë dhe këshillës reciproke, obligueshmërinë e besimit, durimit, vërtetësisë, dhe dëshmon gjithashtu se s’ka rrugë tjetër drejt lumturisë dhe triumfit përveç se me këto katër cilësi.

Dhe tha Bukhari,¹¹ Allahu e mëshiroftë: “Kapitull: dija vjen para fjalës dhe punës.” Dhe argumenti është Fjala e të Lartësuarit:

﴿فَاعْلَمْ أَنَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَاسْتَغْفِرْ لِذَنْبِكَ﴾

“Andaj, dije se s’ka të adhuruar tjetër me të drejtë pos Allahut, dhe kërko falje për gjynahun tënd.” [Muhammed, 19]

Pra, ai filloi me dijen përpara fjalës dhe punës.

Dije – Allahu të mëshiroftë – se është detyrë për çdo Musliman e Muslimane që t’i dijë këto tri çështje¹² dhe të punojë me to:

Ë para: që Allahu na ka krijuar e furnizuar dhe nuk na ka braktisur.¹³

¹¹ El-Bukhari është Ebu ‘Abdullah Muhammed Ibn Isma’il Ibn Ibrahim el-Bukhari, nga Bukharaja, në Lindjen e mesme. Lindi në mesin e shekullit të tretë. Ka qenë në moshën 26 vjeçare kur shkroi Sahihun e tij. Ai ka gjithashtu vepra të tjera madhështore e të dobishme, Allahu pastë mëshirë për të.

Ai thotë: “Kapitull: dija vjen para fjalës dhe punës.” Kjo për shkak të Fjalës së Allahut të Përsosur nga çdo e metë: “**Andaj, dije se s’ka të adhuruar tjetër me të drejtë pos Allahut.**” Pra, ai filloi me dijen përpara fjalës dhe punës. Kështu që, njeriu e ka detyrë që së pari të mësojë, pastaj të punojë. Pra, të mësojë Fenë e tij dhe të punojë me dije të qartë. Dhe Allahu e di më së miri.

¹² Këto tri çështje janë nga çështjet më të rëndësishme që lidhen me Teuhidin dhe të drejtat e tij.

¹³ Allahu i krijoi krijesat që ata ta adhurojnë Atë, dhe nuk i krijoi ata që më pas t’i braktiste, t’i linte në jetë kot e pa qëllim, porse Ai i krijoi ata për një çështje e urtësi madhështore, në të cilën gjendet lumturia dhe shpëtimi i tyre, e cila është: që ta adhurojnë Allahun të vetëm e pa i shoqëruar askënd në adhurim. Sikurse ka thënë i Lartësuar: “Dhe Unë nuk i kam krijuar xhindët dhe njerëzit përveç se që të më adhurojnë Mua.” [edh-Dharijjat, 56] Dhe me këtë adhurim Allahu i ka urdhëruar ata në Fjalën e Tij: “O ju njerëz adhuroni Zotin tuaj!” [el-Bekarah, 21] Si dhe në Fjalën e të Lartësuarit: “Dhe ka urdhëruar Zoti yt që të mos adhurosh askënd tjetër pos Atij.” [el-Israa`, 23] Si dhe në Fjalën e Tij: “Andaj adhurojeni Allahun dhe mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim).” [en-Nisa`, 36] Si dhe në Fjalën e Tij:

“Andaj adhurojeni Allahun me sinqeritet duke ia dedikuar Fenë vetëm Atij.” [ez-Zumer, 2] Si dhe në Fjalën e Tij: “Dhe ata nuk u urdhëruan përveç se që ta adhuronin Allahun me sinqeritet duke ia dedikuar Fenë vetëm Atij.” [el-Bejjineh, 5] Në ajete të shumta Ai i ka urdhëruar ata me adhurim, dhe adhurimi është Teuhidi i Allahut të Madhërishëm e të Lartësuar dhe veçimi i Tij me adhurim, siç është lutja (*ed-du'aa*), frika (*el-khauf*), shpresa (*er-raxhaa'*), mbështetja (*et-teuekkul*), dëshira dhe përmallimi (*er-ragbeh*), tmërri (*er-rrahbeh*), namazi (*es-salatu*), agjërimi (*es-saum*), si dhe lloje të tjera të adhurimit. Pra, Allahu i Madhëruar e i Lartësuar është Ai që e meriton adhurimin dhe askush tjetër pos Tij. Dhe tek adhurimi hyn edhe zbatimi i urdhërave dhe braktisja e gjërave të ndaluara. Pra, kryerja e urdhërave që t'i ka dhënë Allahu dhe i Dërguari i Tij, si dhe braktisja e gjërave që na i ka ndaluar Allahu dhe i Dërguari i Tij, e gjithë kjo është prej adhurimit. Dhe ky është Islami, kjo është Feja, ky është Imani dhe Udhëzimi. Prandaj mos u fal për askënd tjetër pos Allahut, mos iu përul (në ruku) askujt tjetër pos Tij, mos prij kurban për askënd tjetër pos Tij, mos iu lut askujt tjetër pos Tij, mos iu mbështet askujt tjetër pos Atij, sikurse të gjitha llojet e tjera të adhurimit. Kurse kur i kërkon ndihmë (*el-isti'aneh*) atij që është prezent dhe ka mundësi të të ndihmojë, kjo nuk është ibadet, sikurse ka thënë i Përsosuri nga çdo e metë tek historia e Musait: **“Ai i palës së vet i kërkoj ndihmë (Musait) kundër atij të popullit armik.”** [el-Kasas, 15] – sepse me të vërtetë Musai kishte mundësi që ta ndihmonte atë. Ama për sa i përket lutjes drejtuar të vdekurit, apo lutjes drejtuar atij që nuk është prezent, atij që nuk e dëgjon fjalën tënde, apo lutja drejtuar idhullit, apo xhindit, apo pemëve etj., atëherë ky është pikërisht shirku i mushrikëve. Dhe ky është shirku i madh, për të cilin Allahu ka thënë: **“Me të vërtete, s'ka dyshim se shirku është padrejtësi e madhe.”** [Lukman, 13] Dhe ka thënë i Lartësuari: **“E nëse bëjnë shirk, atyre do t'u asgjësohen veprat që kanë bërë.”** [el-En'am, 88] Dhe ka thënë i Përsosuri nga çdo e metë: **“Me të vërtetë Allahu nuk fal që Atij t'i bëhet shirk, kurse të tjerat përveç kësaj ia fal kujt të dojë Ai.”** [en-Nisa', 116] Dhe ka thënë i Përsosuri nga çdo e metë: **“E padyshim, tashmë të është shpallur ty dhe atyre që ishin para teje se po bërë shirk do të asgjesohet puna jote.”** [ez-Zumer, 65]

Pra, Allahu na krijoi dhe na furnizoi dhe nuk na ka lënë të jetojmë të braktisur, por na urdhëroi që ta veçojmë Atë, t'i bindemi dhe t'i lëmë gjynahet dhe mosbindjen ndaj Tij.

Përkundrazi, ai na dërgoi një të dërguar¹⁴: kush i bindet atij hyn në Xhenet, e kush nuk i bindet hyn në Zjarr.¹⁵ Dhe argumenti është Fjala e të Lartësuarit:

﴿إِنَّا أَرْسَلْنَا إِلَيْكُمْ رَسُولًا شَاهِدًا عَلَيْكُمْ كَمَا أَرْسَلْنَا إِلَىٰ فِرْعَوْنَ رَسُولًا ﴿١٥﴾﴾

﴿فَعَصَىٰ فِرْعَوْنُ الرَّسُولَ فَأَخَذْنَاهُ أَخْذًا وَبِيلاً ﴿١٦﴾﴾

“Ne, me të vërtetë, ju kemi sjellë një të Dërguar dëshmitar mbi ju, ashtu siç ia çuam një të dërguar Faraonit. Por Faraoni nuk iu bind të Dërguarit, andaj i çuam dënim të rëndë.” [el-Muzemmil, 15-16]

Ë dyta¹⁶: që Allahu nuk është i kënaqur që t'i shoqërohet dikush në adhurimin e Tij, as ndonjë melek që është i afërt tek Ai, e as ndonjë pejgamber i dërguar.

¹⁴ Dhe na dërgoi neve një të dërguar, i cili është Muhamedi (*'alejhissalatu ues-selam*), siç e thamë më herët. Allahu i zbriti atij Kur'anin, që ne të udhëzohemi me të në Rrugën e Drejtë, të punojmë me urdhërat e tij, të përmbahemi nga ndalesat e tij, si dhe t'i përmbahemi udhëzimit të Muhamedit, të Dërguarit të Allahut (*salAllahu 'alejhi ue sellem*), Vula e Pejgamberëve dhe të Dërguarëve, i cili erdhi që t'u mësojë njerëzve fenë e tyre. Pra, ai është Vula e Pejgamberëve, Imami i tyre dhe më i miri prej tyre.

¹⁵ Pra, kush i bindet këtij të Dërguari i përmbahet fesë së tij, për të është Xheneti. Dhe kush nuk i bindet këtij të Dërguari dhe devijon nga Feja e tij, për të është Zjarr. Sikurse ka thënë i Lartësuarit: **“Ne, me të vërtetë, ju kemi sjellë një të Dërguar dëshmitar mbi ju.”** – domethënë: dëshmitar i veprave tuaja. **“ashtu siç ia çuam një të dërguar Faraonit”** – pra, ai ishte i dërguar (*'alejhissalatu ues-selam*). **“por Faraoni nuk iu bind të Dërguarit, andaj i çuam dënim të rëndë.”** – domethënë: e dënuam Faraonin me dënim të rëndë në dynja, me mbytje, kurse në Ahiret me Zjarr.

¹⁶ Kjo çështja e dytë në të vërtetë është përmbushje e çështjes së parë: që ta dish se Allahu nuk është i kënaqur që t'i shoqërohet dikush në adhurimin e Tij, pasi Ai është Krijuesi, Furnizuesi, Dhënësi i jetës dhe i vdekjes, Ai i Cili të krijoj dhe të dha mirësitë. Prandaj Ai, i Përsosuri nga çdo e metë, nuk është i kënaqur që t'i shoqërohet dikush tjetër nga krijesat, as ndonjë pejgamber i

Argumenti është Fjala e të Lartësuarit:

﴿وَأَنَّ الْمَسْجِدَ لِلَّهِ فَلَا تَدْعُوا مَعَ اللَّهِ أَحَدًا﴾

“Ë me të vërtetë xhamitë janë të Allahut, prandaj mos iu lutni askujt tjetër krahas Allahut.” [el-Xhinn, 18]

Ë treta¹⁷: se kush i bindet të Dërguarit dhe e veçon Allahun, nuk i lejohet atij që të miqësojë atë që kundërshton Allahun dhe të

dërguar, as ndonjë melek i afërt e as ndonjë tjetër, ngase adhurimi është e drejtë që i takon vetëm Allahut. Sikurse ka thënë i Lartësuarit: “Dhe ka urdhëruar Zoti yt që të mos adhurosh askënd tjetër pos Atij.” [el-Israa`, 23] Dhe siç ka thënë i Lartësuarit: “Ty të vetëm të adhurojmë dhe vetëm nga Ty ndihmë kërkojmë.” Sepse të bërit ortak Atij është gjynahu më i madh nga të gjitha gjynahet. Dhe ka ardhur në ajete të shumta urdhëri që adhurimi të bëhet me sinqeritet vetëm për Allahun, si dhe ndalimi nga adhurimi i të tjerëve pos Atij. Andaj, bëji bashkë këto dy urdhëra dhe beso që Allahu është Krijuesi, Furnizuesi dhe Dhënësi i jetës dhe i vdekjes, e të besosh që i Përsosuri nga çdo e metë, Ai e meriton adhurimin, siç është prerja e kurbanit, namazi, agjërimi, si dhe llojet e tjera të adhurimit, ashtu siç ka thënë i Përsosuri nga çdo e metë: “Dhe i adhuruari juaj me të drejtë është një i vetëm.” [el-Bekarah, 163] Dhe ka thënë i Përsosuri nga çdo e metë: “Andaj mos i lut askujt tjetër krahas Allahut.” [el-Xhinn, 18]

¹⁷ Dhe kjo është çështja e tretë: dhe ajo është prej obligimeve më të rëndësishme, që ta dijë çdo Musliman e Muslimane se nuk u lejohet atyre që t'i miqësojnë mushrikët apo t'i duan ata. Prandaj, kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, dhe e veçon Allahun *Xhelle ue 'Alaa*, ai obligohet që t'i armiqësojnë mosbesimtarët dhe t'i urrejë për hir të Allahut. Dhe nuk i lejohet atij që t'i miqësojë e t'i dojë ata, për shkak të Fjalës së të Lartësuarit: “Nuk gjen njerëz” - domethënë: nuk gjen ti o Muhamed njerëz me iman të vërtetë që të duan ata që kundërshtojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Dhe ka thënë i Lartësuarit: “O ju që besoni, mos i bëni miq e mbrojtës hebrejtë dhe të krishterët! Ata janë mbrojtës të njëri-tjetrit. Kushdo prej jush që i bën ata miq, është me ata. Vërtet, Allahu nuk i udhëzon në rrugë të drejtë keqbërësit.” [el-Ma`ideh, 51] Dhe ka thënë Allahu *'Azze ue Xhelle*: “Shembull i mrekullueshëm për ju është Ibrahimimi dhe ata që kanë qenë me të, kur i

thanë popullit të vet: “Ne distancohemi nga ju dhe nga ato që ju i adhuroni në vend të Allahut; ne ju mohojmë dhe armiqësia e urrejtja midis nesh është e përhershme, derisa të besoni tek Allahu Një dhe i Vetëm.” [el-Mumtehineh, 4] Pra, duhet patjetër që të ketë urrejtje dhe armiqësi ndaj armiqve të Allahut, ndërkohë që duhet patur miqësi dhe dashuri për Besimtarët. Kështu është Besimtari: do ata që i do Allahu dhe bashkëpunon me ata në mirësi, si dhe urren dhe ka neveri për armiqtë e Allahut dhe i armiqëson ata për hir të Allahut, edhe nëqoftëse i thërret ata tek Allahu, edhe nëqoftëse i pranon ata në vendin e tij apo merr xhizjen (taksën e qëndrimit në tokat e Muslimanëve) prej tyre, siç vepron udhëheqësi. Ngase i Dërguari (*sal-lAllahu ‘alejhi ue sellem*) ua merrte xhizjen Çifutëve, të Krishterëve dhe Mexhusëve, si ndihmë për Muslimanët, e jo duke patur dashuri për ata (Çifutët, të Krishterët dhe Mexhusët). Merret xhizja nga ata nëqoftëse nuk hyjnë në Islam dhe nuk luftojnë, e për më tepër ata pranojnë të jetojnë (në tokat e Muslimanëve) duke patur urrejtje për ta për hir të Allahut dhe duke mos i miqësuar. E nëse ata nuk e pranojnë Islamin dhe as nuk pranojnë të japin xhizjen, atëherë luftohen në varësi të fuqisë (së Muslimanëve), dhe kjo është vetëm për Ehli-Kitabët (Çifutët dhe të Krishterët) dhe Mexhusët. Ama sa i përket pjesës tjetër të mosbesimtarëve, atyre nuk u pranohet xhizja, porse luftohen derisa të hyjnë në Islam, siç janë idhujtarët, komunistët dhe kategoritë e tjera të mosbesimtarëve. Kjo bëhet nëse Muslimanët kanë fuqi për t’i luftuar, për shkak se Allahu i Përsosur nga çdo e metë ka thënë: “Dilni në luftë, qofshi të shëndoshë ose të sëmurë dhe luftoni me pasurinë e jetën tuaj në rrugën e Allahut! Kjo është më mirë për ju, veç sikur ta dinit!” [et-Teubeh, 41] Dhe ka thënë Allahu i Përsosur nga çdo e metë: “Kur të kalojnë muajt e shenjtë (në të cilët ndalohet lufta), atëherë i vritni idhujtarët kudo që t’i ndeshni, i zini robër, i rrethoni dhe u bëni pusi kudo! Por, nëse pendohen, falin namazin dhe japin zekatin, atëherë i lini të qetë! Vërtet, Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.” [et-Teubeh, 5] Dhe ajetet me këtë kuptim janë të shumta. Dhe Allahu i Përsosur nga çdo e metë ka për qëllim luftimin e tyre duke patur fuqinë për t’i luftuar ata, ngase Allahu *‘Azze ue Xhel-le* ka thënë: “Allahu nuk e ngarkon askënd përtej fuqisë që ka.” [el-Bekarah, 286] Dhe ka thënë i Përsosuri nga çdo e metë: “Andaj kijeni frikë Allahun (duke iu përmbajtur urdhërave të Tij) sa të keni mundësi.” [et-Tegabun, 16] Dhe sepse Pejgamberi (*sal-lAllahu ‘alejhi ue sellem*) nuk i luftoi mushrikët (idhujtarët) derisa arriti fuqinë për t’i luftuar ata. I Lartësuaru tha më pas në fundin e ajetit: “Allahu ka skalitur besimin në zemrat e tyre dhe i ka

Dërguarin e Tij, edhe në qoftë ai prej njerëzve më të afërt. Dhe argumenti është Fjala e të ʿArtësuarit:

﴿لَا تَجِدُ قَوْمًا يُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ يُوَادُّونَ مَنْ حَادَّ اللَّهَ وَرَسُولَهُ وَلَوْ كَانُوا
ءَابَاءَهُمْ أَوْ أَبْنَاءَهُمْ أَوْ إِخْوَانَهُمْ أَوْ عَشِيرَتَهُمْ أُولَئِكَ كَتَبَ فِي قُلُوبِهِمُ الْإِيمَانَ وَأَيَّدَهُمْ
بِرُوحٍ مِّنْهُ وَيُدْخِلُهُمْ جَنَّاتٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمْ
وَرَضُوا عَنْهُ أُولَئِكَ حِزْبُ اللَّهِ أَلَا إِنَّ حِزْبَ اللَّهِ هُمُ الْمُفْلِحُونَ﴾

“Nuk gjen njerëz, që besojnë në Allahun dhe në Ditën e Fundit, që të ushqejnë dashuri ndaj atyre, të cilët kundërshtojnë Allahun dhe të Dërguarin e tij, edhe në qofshin ata etërit e tyre ose bijtë e tyre, ose vëllezërit e tyre, ose farefisi i tyre. Allahu ka skalitur besimin në zemrat e tyre dhe i ka fuqizuar ata me shpalljen e Vet. Ai do t'i shpjerë ata në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj e ku do të qëndrojnë përgjithmonë. Allahu është i kënaqur me ata, por edhe ata do të jenë të kënaqur me Të. Ata janë Pala e Allahut dhe, vërtet që Pala e Allahut do të jetë fituese.” [el-Muxhadileh, 22]

Dije, Allahu të udhëzofte në bindjen ndaj Tij¹⁸, se Hanifija¹⁰ është feja e Ibrahimit, dhe ajo është: që ta adhurosh Allahun të vetëm, duke e bërë të githë adhurimin me sinqeritet vetëm për Atë.

fuqizuar ata me shpalljen e Vet.” [el-Muxhadileh, 22] Domethënë, Allahu i fuqizoi ata me fuqi prej Tij.

¹⁸ Ai - Allahu e mëshiroftë - tha: “Dije, Allahu të udhëzofte në bindjen ndaj Tij” - pra, ai bashkoi dhënien e mësimin me bërjen e duasë (për atë që po mëson).

¹⁹ “Hanifija është feja e Ibrahimit: dhe ajo është: që ta adhurosh Allahun të vetëm, duke e bërë të githë adhurimin me sinqeritet vetëm për Atë” - dhe ajo është feja për të cilën Allahu i tha Pejgamberit të Tij: “Pastaj ty të shpallëm: Paso me sinqeritet fenë e Ibrahimit, që ishte Hanijf (nuk ka qenë prej idhujtarëve).” [en-Nahl, 123] Pra, el-Hanijfeh është feja që

Dhe me këtë Allahu ka urdhëruar të gjithë njerëzit, si dhe i ka krijuar për këtë²⁰, sikurse ka thënë Allahu i Lartësuar:

﴿وَمَا خَلَقْتُ الْجِنَّ وَالْإِنْسَ إِلَّا لِيَعْبُدُونِ﴾

“Dhe Unë nuk i kam krijuar xhindët dhe njerëzit përveç se që të më adhurojnë Mua.” [edh-Dharijat, 56]

- **“të më adhurojnë Mua”** do të thotë: të më veçojnë Mua në adhurim.

ka adhurimin e pastër për Allahun, miqësinë për hir të Tij dhe braktisjen e të bërit shirk Allahut të Përsosur nga çdo e metë. Kurse *el-Hanijf* është ai që është i kthyer nga Allahu dhe ka braktisur gjithçka tjetër që adhurohet në vend të Atij, duke e bërë adhurimin me sinqeritet vetëm për Allahun, siç ishte Ibrahim i dhe pasuesit e tij, e kështu janë edhe peygamberët e tjerë me pasuesit e tij.

²⁰ Ai tha: **“Dhe me këtë Allahu ka urdhëruar të gjithë njerëzit, si dhe i ka krijuar për këtë”** - pra Ai i urdhëroi ata me Teuhid dhe sinqeritet dhe i krijoi që ta adhurojnë Atë; i urdhëroi që ta adhurojnë Atë të vetëm në namazin e tyre, në agjërimin e tyre, në lutjet e tyre, në frikën e tyre, në shpresën e tyre, në kurbanin e tyre, në zotimin e tyre dhe në të gjitha format e tjera të adhurimit. Të gjitha ato adhurime janë vetëm për Allahun, sikurse ka thënë i Lartësuari: **“Zoti yt ka urdhëruar, që të mos adhuroni askënd tjetër përveç Atij.”** [el-Israa`, 23] Dhe Ai ka thënë: **“Ty të Vetëm të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.”** [el-Fatihah, 5] Dhe ka thënë i Përsosuri nga çdo e metë: **“Andaj adhurojeni Allahun duke e bërë adhurimin me sinqeritet vetëm për Atë!”** [ez-Zumer, 2] Dhe ka thënë i Përsosuri nga çdo e metë: **“O ju njerëz adhuroni Zotin tuaj!”** [el-Bekarah, 21] Ky është adhurimi për të cilin u krijuan njerëzit. Për të u krijuan xhindët dhe njerëzit, dhe ky është Teuhidi i Allahut dhe bindja ndaj urdhërave të Tij dhe largimi nga gjërat që Ai ua ka ndaluar. Ka thënë i Lartësuari: **“Dhe Unë nuk i kam krijuar xhindët dhe njerëzit përveç se që të më adhurojnë Mua.”** [edh-Dharijat, 56] Domethënë, të më veçojnë Mua në adhurim, ta bëjnë adhurimin vetëm për Mua, duke kryer urdhërat dhe duke braktisur gjërat e ndaluara, siç ka ardhur dhe në shumë ajete të tjera.

Dhe urdhëri më i madh nga Allahu është Teuhidi²¹, i cili është: veçimi i Allahut në adhurim.

Kurse ndalesa më e madhe nga Allahu është Shirk²², që është: t'i lutesh dikujt tjetër krahas Allahut.

²¹ **“Dhe urdhëri më i madh nga Allahu është Teuhidi, i cili është: veçimi i Allahut në adhurim”** – pra me adhurimin tënd ti ke për qëllim vetëm Allahun e askënd tjetër pos Tij, kështu që, as nuk adhuron krahas Atij ndonjë idhull, as ndonjë profet, as ndonjë melek, as ndonjë gur, as ndonjë xhind e as ndonjë gjë tjetër.

²² **“Shirku është: t'i lutesh dikujt tjetër krahas Allahut”** – dhe ka thënë i Përsosuri nga çdo e metë: **“E nëse i bëjnë shirk Allahut, padyshim që atyre do t'u asgjësohen veprat që kanë bërë.”** [el-En'am, 88] Dhe ka thënë i Përsosuri nga çdo e metë: **“Me të vërtetë, të është shpallur ty (o Muhamed), si dhe atyre që kanë qenë para teje: “Nëse i shoqëron Allahut diçka tjetër (në adhurim), me siguri që punët e tua do të zhvlerësohen dhe do të jesh ndër të humburit.”** [ez-Zumer, 65] Dhe tek dy Sahihët ka ardhur se Pejgamberi (*sal-Allahu 'alejhi ue sellem*) u pyet: Cili është gjynahu më i madh? Ai tha: **“T'i bësh Allahut dikë të barabartë me Të, ndërkohë që Ai të ka krijuar ty.”** I thanë: Cili është më pas? Ai tha: **“Që të vrasësh birin tënd nga frika se mos ai ha nga ushqimi jot.”** I thanë: Cili është më pas? Ai tha: **“Të bësh zina me gruan e komshiut tënd.”** Pra, Pejgamberi (*sal-Allahu 'alejhi ue sellem*) e bëri të qartë që Shirku është padrejtësia më e madhe, më e rëndë dhe më e rrezikshme. Dhe në një hadith tjetër, ai (*sal-Allahu 'alejhi ue sellem*) thotë: **“A t'ju njoftoj për gjynahun më të madh?”** Thamë: Posi jo o i Dërguari i Allahu! Ai tha: **“Të bërit shirk Allahut.”** Hadithin e ka transmetuar Bukhari dhe Muslimi. Pra, Teuhidi është: ta veçosh Allahun me ibadet (adhurim). Kurse Shirku është: t'i lutesh dikujt tjetër krahas Allahut, pra t'i lutesh atij, t'i frikësohesh, të shpresosh nga ai, të bësh kurban për të, të zotohesh në të dhe t'i dedikosh atij forma të tjera të ibadetit krahas Allahut. Ky është Shirku i Madh, qoftë i luturi profet apo xhind apo pemë apo gur apo çfarëdo gjëje tjetër. Prandaj ka thënë i Lartësuar: **“Andaj adhurojeni Allahun dhe mos i shoqëroni askënd Atij në adhurim.”** **“asgjë”** – është në trajtën e pashquar që vjen në kuptimin e mohimit dhe kështu që ajo përfshin gjithçka. Dhe ka thënë i Përsosuri nga çdo e metë: **“Dhe ata qenë urdhëruar vetëm që të adhuronin Allahun me sinqeritet,**

Dhe argumenti është Fjala e të Cartësuarit:

﴿وَأَعْبُدُوا اللَّهَ وَلَا تُشْرِكُوا بِهِ شَيْئًا﴾

“Andaj adhurojeni Allahun dhe mos i shoqëroni askënd Atij në adhurim.” [en-Nisaa’, 36]

Ë nëse të thonë: Cilat janë tre parimet²³ themelore që njeriu e ka detyrë t’i dijë?

Atëherë thuaj: Që robi të njohë Zotin e tij, Fenë e tij dhe Pejgamberin e tij, Muhamedin.

duke e bërë adhurimin vetëm për Atë.” [el-Bejjineh, 5] Pra, gjëja më e madhe që ka urdhëruar Allahu është Teuhidi, që është veçimi i Allahut me adhurim, kurse gjëja më e madhe që ka ndaluar Allahu është të bërit shirk Allahut ‘Azze ue Xhel-le, siç u tha më përpara. Për këtë arsye Allahu *Subhanehu ue Te’ala* e ka përmendur shumë në Kur’an urdhërin e Teuhidit dhe ndalimin e shirkut.

²³ Këto tri parime përmbledhin të gjithë Fenë: Kush është Zoti yt? Cila është feja jote? Kush është profeti jot? Dhe këto janë ato tri pyetjet që i bëhen robit në varrin e tij.

Parimi i Parë: që robi të njohë Zotin e tij

Ë nëse të thonë²⁴: Kush është Zoti yt?

Atëherë thuaj²⁵: Zoti im është Ai që më ka krijuar dhe furnizuar mua dhe të gjitha botët me mirësitë e Tij, dhe Ai është i Adhuruari im, pos të Cilit nuk kam asnjë të adhuruar tjetër.

Dhe argumenti²⁶ është Fjala e të Lartësuarit:

﴿الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ﴾

²⁴ Pra, nëse të pyet ndokush: Kush është Zoti yt?

²⁵ "Atëherë thuaj: Zoti im është Ai që më ka krijuar dhe furnizuar mua dhe të gjitha botët me mirësitë e Tij, dhe Ai është i Adhuruari im, pos të Cilit nuk kam asnjë të adhuruar tjetër." - Ky është Zoti i të gjitha botëve, sikurse ka thënë i Lartësuarit: "Të gjitha lavdet i takojnë Allahut, Zotit të botëve." Dhe tek "botët" [el-Alemin] hyjnë të gjitha krijesat, xhindët, njerëzit, kafshët, malet, pemët, që të gjitha këto janë pjesë e botës. Ka thënë i Lartësuarit: "Në të vërtetë, Zoti juaj është Allahu, i Cili krijoi qiejt dhe Tokën për gjashtë ditë e pastaj u ngrit mbi Arsh. Ai me errësirën e natës e mbulon ditën, e cila e ndjek atë; Dielli, Hëna dhe yjet i përulen urdhrin të Tij. Vetëm Atij i përket Krijimi dhe Urdhërimi. I pashtershëm është bereqeti i Allahut, Zoti i botëve!" [el-E'araf, 54] Pra, Ai është Zoti i gjithçkaje, i Tij është krijimi dhe i Tij është urdhërimi, dhe vetëm Ai meriton të adhurohet. Prandaj ka thënë i Përsosuri nga çdo e metë: "O ju njerëz adhuroni Zotin tuaj..." [el-Bekarah, 21] Dhe Ai është i Adhuruari im, pos të Cilit nuk kam asnjë të adhuruar tjetër.

²⁶ "Dhe argumenti është Fjala e të Lartësuarit: "Të gjitha lavdet i takojnë Allahut, Zotit të Botëve." [el-Fatihah, 2]" - domethënë, të gjitha lavdërimet janë për Allahun, dhe adhurimi është prej lavdërimit dhe falenderimit.

“Çë gjitha lavdet i takojnë Allahut, Zotit të Botëve.” [el-Fatihah, 2]

Dhe tek bota [el-Alem] hyn gjithçka²⁷, me përjashtim të Allahut, dhe unë jam pjesë e asaj bote.²⁸

E nëse të thonë²⁹: Qysh e njohe Zotin tënd?

Atëherë thuaj³⁰: Njëpërmjet shenjave dhe krijesave të Tij. E prej shenjave të Allahut është nata dhe dita, Dielli dhe Hëna. Kurse

²⁷ “Dhe tek bota [el-Alem] hyn gjithçka, me përjashtim të Allahut” – pra xhindët, njerëzit, kafshët dhe malet, të gjitha këto hyjnë tek botët [el-Alemiin].

²⁸ “dhe unë jam pjesë e asaj bote” – të cilën e krijoi Allahu dhe e solli në egzistencë dhe ua obligoi banorëve të saj që t’i binden Atij. Kështu që, të gjitha botët dhe ata që janë të ngarkuar me detyrat e Sheriatit, prej xhindëve dhe njerëzve, janë të obliguar që t’i binden Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe ta veçojnë Allahun *Xhel-le ue ‘Alaa* në adhurim. Po ashtu, edhe Melaiket janë të obliguar që ta adhurojnë Allahun të vetëm. Prandaj ka thënë i Lartësuar për Melaiket: “Ata nuk i kundërshtojnë urdhërat e Allahut, por i zbatojnë menjëherë ato.” [et-Tahriim, 6] “Ata nuk flasin para (Fjalës së) Tij dhe veprojnë me Urdhërin e Tij. Ai e di se ç’ka para tyre (ç’kanë vepruar) dhe ç’ka pas tyre (çfarë do të veprojnë), ndërsa ata ndërmjetësojnë vetëm për atë me të cilin Ai është i kënaqur, e prej frikës së Tij qëndrojnë me nderim dhe frikë.” [el-Enbija`, 27-28]

²⁹ Nëse të thonë ty o Musliman: Qysh e njohe Zotin tënd të Cilin ti e adhuron?

³⁰ Atëherë thuaj: E njoha Atë njëpërmjet shenjave dhe krijesave të Tij, pra nga shenjat e shumta dhe nga krijesat e mahnitshme të cilat tregojnë se Ai është Zoti i Madhërisëm dhe Krijuesi i Gjithëdijshëm, se vetëm Ai meriton të adhurohet, se Ai krijon ç’të dojë, se Ai është që jep dhe privon, Ai të jep dobi dhe Ai të dëmton, çdo gjë është në Dorën e Tij, i Përsosuri e i Lartësuar nga çdo e metë e mangësi. Ai meriton që ta adhurojmë duke iu bindur, duke iu lutur, duke i kërkuar ndihmë dhe me të gjitha punët dhe adhurimet tona, ngase Allahu na krijoi për këtë gjë. Ka thënë i Lartësuar: “Dhe Unë nuk i kam krijuar xhindët dhe njerëzit përveç se që ata të më adhurojnë Mua.”

prej krijesave të Tij janë shtatë qiejt e shtatë tokat dhe gjithçka që ndodhet brenda tyre e ndërmjet tyre.

Dhe argumenti është Fjala e të ʿArtësuarit:

﴿وَمِنَ آيَاتِهِ اللَّيْلُ وَالنَّهَارُ وَالشَّمْسُ وَالْقَمَرُ لَا تَسْجُدُوا لِلشَّمْسِ وَلَا لِلْقَمَرِ فَاسْجُدُوا

لِلَّهِ الَّذِي خَلَقَهُنَّ ۚ إِنَّ كُنتُمْ إِيَّاهُ تَعْبُدُونَ ﴿٣٧﴾

“Ndër shenjat e Tij janë nata dhe dita, si dhe Dielli dhe Hëna. Mos bëni sexhde as për Diellin, as për Hënë, por, nëse jeni adhurues të Atij, bëni sexhde për Allahun i Cili i ka krijuar atol” [Fussilet, 37]³¹

Dhe Fjala e të ʿArtësuarit:

Dhe ky adhurim është veçimi i Tij, bindja ndaj Tij, pasimi i Ligjit të Tij dhe madhërimi i urdhëresave dhe ndalesave të Tij me fjalë dhe vepra.

³¹ **“Ndër shenjat e Tij janë nata dhe dita, si dhe Dielli dhe Hëna.”** – Të gjitha këto tregojnë se Ai është Zoti i botëve dhe se Ai është Krijuesi i Gjithëdijshëm. Vjen nata me errësirën e saj dhe ikën dita me dritën e saj, pastaj vjen dita dhe ikën nata. Dhe ky Diell ngrihet lart mbi të gjithë botën dhe të gjithë kanë dobi nga ai. Edhe Hëna po ashtu, si dhe shenja të tjera madhështore, siç është toka dhe krejt ç’ka në të, malet, lumenjtë, detet, pemët dhe kafshët. Po ashtu edhe këto qiej që i shikojnë njerëzit, të gjitha ato janë prej shenjave që tregojnë për madhësitinë e Tij dhe se Ai është Zoti i botëve, se Ai është Krijuesi i Gjithëdijshëm dhe se vetëm Ai e meriton adhurimin. Prandaj Ai tha: **“Ndër shenjat e Tij janë nata dhe dita, si dhe Dielli dhe Hëna. Mos bëni sexhde as për Diellin, as për Hënë, por, nëse jeni adhurues të Atij, bëni sexhde për Allahun i Cili i ka krijuar atol”** – Domethënë, mos i adhuroni këto krijesa por adhuroni Atë që i krijoi dhe i solli ato në egzistencë, Atë që është i Përsosur e i Lartësuar nga çdo e metë, pasi vetëm Ai meriton që robi t’i nënshtrohet, t’i përulet, t’u bindet urdhërave të Tij dhe të qëndrojë larg ndalesave të Tij (Subhanehu ue Te’ala), duke e madhëruar Atë, duke mohuar çdo mangësi apo të metë apo të ngjashëm për Të, duke iu frikësuar Atij dhe duke qenë i përmalluar për atë që premtom Ai.

﴿إِنَّ رَبَّكُمُ اللَّهُ الَّذِي خَلَقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ فِي سِتَّةِ أَيَّامٍ ثُمَّ اسْتَوَىٰ عَلَى الْعَرْشِ يُغْثِي اللَّيْلَ النَّهَارَ يَطْلُبُهُ حَثِيثًا وَالشَّمْسَ وَالْقَمَرَ وَالنُّجُومَ مُسَخَّرَاتٍ بِأَمْرِهِ ۗ أَلَا لَهُ الْخَلْقُ وَالْأَمْرُ ۗ تَبَارَكَ اللَّهُ رَبُّ الْعَالَمِينَ﴾

“Në të vërtetë, Zoti juaj është Allahu, i Cili krijoi qiejt dhe Tokën për gjashtë ditë e pastaj u ngrit mbi Arsh. Ai me errësirën e natës e mbulon ditën, e cila e ndjek atë; Dielli, Hëna dhe yjet i përulen urdhrit të Tij. Vetëm Atij i përket Krijimi dhe Urdhërimi. I pashtershëm është bereqeti i Allahut, Zoti i botëve!” [el-‘Araf, 54]³²

³² Dhe ka thënë i Përsosuri nga çdo e metë: “Në të vërtetë, Zoti juaj është Allahu” – domethënë, në të vërtetë Zoti juaj - o ju robër nga xhindët e nga njerëzit - është Allahu. “Zoti juaj” domethënë Krijuesi juaj, dhe Ai është i Adhuruari juaj i Vërtetë, i Vetmi, i Cili nuk ka asnjë ortak. “...i Cili krijoi qiejt dhe Tokën për gjashtë ditë e pastaj u ngrit mbi Arsh” – domethënë, më pas Ai u ngrit lart mbi Arsh dhe mbi të është Allahu *Subhanehu ue Te’ala*. Këshu që, dija e Tij është kudo, kurse Ai është mbi Arsh, mbi të gjitha krijesat. Arshi është çatia e krijesave dhe ai është krijesa më e lartë, dhe Allahu *Xhel-le ue ‘Alaa* është mbi të, u ngrit lart mbi të ashtu siç i ka hije Madhërisë së Tij që të ngrihet, duke mos përngjasuar aspak krijesat e Tij me Cilësitë e Tij. Ka thënë i Lartësuar: “Asgjë nuk është e ngjashme me Të, dhe Ai është Gjithëdëgjuesi dhe Gjithëshikuesi.” [esh-Shuura, 11] Dhe ka thënë i Lartësuar: “Dhe askush nuk është i barabartë me Të.” [el-Ikhlâs, 4] Kurse Fjala e Tij: “Ai me errësirën e natës e mbulon ditën, e cila e ndjek atë” – do të thotë, Ai e mbulon atë me këtë dhe anasjelltas. “e cila e ndjek atë” – domethënë, menjëherë, dhe secila prej tyre shkon mbas tjetrës, nëse mbaron kjo hyn ajo tjetra, vazhdojnë kështu derisa të vijë Ora e Fundit. “Dielli, Hëna dhe yjet” – domethënë, Ai krijoi Diellin, Hënën dhe yjet, i krijoi ato të nënshtruara nën urdhërin e Tij, të bindura e të përlulura para urdhërit të të Përsosurit nga çdo e metë. Pastaj tha i Përsosuri nga çdo e metë: “Vetëm Atij i përket Krijimi dhe Urdhërimi” – pra, krijimi është i Tij dhe urdhërimi është i Tij. Ai është Krijuesi, të Cilit nuk i kundërshtohet urdhëri universal që hyn në fuqi mbi njerëzit, sikurse ka thënë i Lartësuar: “Vërtet, urdhri i Tij, kur Ai dëshiron diçka, është që t’i thotë asaj “Bëhu!” - dhe ajo bëhet.” [Ja-Siin, 82]

Zoti (*er-Rabb*): Ai është i Adhuruari.³³

Dhe argumenti është Fjala e të Lartësuarit:

﴿يٰۤاَيُّهَا النَّاسُ اَعْبُدُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ وَالَّذِينَ مِنْ قَبْلِكُمْ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ ﴿٥١﴾ الَّذِي
جَعَلَ لَكُمُ الْاَرْضَ فِرَاشًا وَالسَّمَاءَ بِنَاءً وَاَنْزَلَ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً فَاَخْرَجَ بِهٖ مِنْ الثَّمَرٰتِ
رِزْقًا لَّكُمْ ﴿٥٢﴾ فَلَا تَجْعَلُوْا لِلّٰهِ اَنْدَادًا وَاَنْتُمْ تَعْلَمُوْنَ ﴿٥٣﴾﴾

“O njerëz adhuroni Zotin tuaj, i Cili ju ka krijuar ju dhe ata që ishin para jush, që të mund të ruheni (nga të këqijat); i Cili e ka bërë për ju tokën shtresë dhe qiellin ndërtesë; i Cili prej qiellit zbrit ujë dhe nëpërmjet tij bën që të rriten fruta si ushqim për ju. Prandaj mos i bëni krijesat të barabarta me Allahun ndërkohë që ju e dini (që s’ka asnjë të barabartë me Allahun).” [el-Bekarah, 21-22]³⁴

Dhe Fjala e Tij: “Ne urdhërojmë vetëm një herë dhe vullneti Ynë përmbushet sa çel e mbyll sytë.” [el-Kamer, 50] Pra, urdhëri universal i përcaktuar i Allahut nuk kundërshtohet nga askush. Prandaj Ai ka thënë: “Vetëm Atij i përket Krijimi dhe Urdhërimi. I pashtershëm është bereqeti i Allahut, Zoti i botëve!” “Tebarake” në ajet domethënë: Ai ka bereqetin absolut dhe kjo frazë nuk bën të përdoret për askënd tjetër pos Allahut. Kështu që, nuk i thuhet robit “Tebarakte ja fulan”, kjo nuk bën të thuhet, porse ajo është e veçantë për Allahun, sikurse ka thënë i Lartësuar: “I pashtershëm është bereqeti i Atij, në Dorën e të Cilit është i gjithë sundimi.” [el-Mulk, 1] Kurse për krijesën thuhet: “BarakAllahu fij fulan” – Allahu i dhëntë bereqet filanit! Ose: “Fulan Mubarak” – Filanit i është dhënë bereqet. Kurse shprehja “Tebarakte” nuk përdoret për askënd tjetër pos Allahut të vetëm.

³³ Zoti (*er-Rabb*): Ai është i Adhuruari, kurse botët (*el-Alemin*) janë të gjitha krijesat, që nga xhindët, njerëzit, qielli, toka... dhe Ai është Zoti i tyre, i Përsosuri dhe i Lartësuar nga çdo e metë e mangësi, dhe Ai është Zoti dhe Krijuesi i të gjitha krijesave, i Madhërishmi e i Larti.

³⁴ Ka thënë i Lartësuar: “O njerëz adhuroni Zotin tuaj, i Cili ju ka krijuar ju dhe ata që ishin para jush, që të mund të ruheni (nga të këqijat).” Ai i krijoi

**Ka thënë Ibn Kethiri, Allahu i Lartësuar pastë mëshirë për të³⁵.
"Krijuesi i këtyre gjërave është Ai që e meriton adhurimin."**

të gjithë ata që kanë qenë përpara nesh dhe ata që do të vijnë mbas nesh nga Ademi. Pastaj tha i Përsosuri dhe i Pastru nga çdo e metë: "... i Cili e ka bërë për ju tokën shtresë..." - pra, Ai i krijoi të gjithë që t'i frikësohen Atij duke zbatuar urdherat e Tij dhe duke u distancuar nga ndalesat e Tij, si dhe që ta adhurojnë Atë, siç ka thënë i Lartësuar: "...që të mund të ruheni (nga të këqijat)." Pastaj, i Përsosuri nga çdo e metë sqaroi veprat e Tij duke thënë: "...i Cili e ka bërë për ju tokën shtresë dhe qiellin ndërtesë..." - pra, Ai e bëri tokën shtresë për njerëzit dhe të sheshtë për ta që të jetojnë në të, të ndërtojnë mbi të, të flenë mbi të, të ecin mbi të, dhe pastaj e përforcoi atë me male. Pastaj tha: "dhe qiellin ndërtesë" - pra, e bëri qiellin ndërtesë dhe çati të mbrojtur dhe e zbukuroi atë me yjet, Diellin dhe Hënë, kurse ata ua kthejnë shpinën të gjitha këtyre shenjave. "...i Cili prej qiellit zbret ujë..." - domethënë prej reve. "...dhe nëpërmjet tij bën që të rriten fruta si ushqim për ju." - lloje të ndryshme ushqimesh në çdo vend, dhe nëpërmjet tij Allahu e ringjall tokën pasiçë ajo ka vdekur. Pastaj tha Allahu i Lartësuar: "Prandaj mos i bëni krijesat të barabarta me Allahun ndërkohë që ju e dini (që s'ka asnjë të barabartë me Allahun)." - domethënë, mos i bëni të barabartë e të njëjtë me Allahun e pastaj t'i adhuron krahas Atij, as ndonjë idhull, as ndonjë xhind, as ndonjë melek e asgjë tjetër. Pra, adhurimi është e drejtë vetëm e Allahut dhe Ai s'ka asnjë të barabartë, asnjë të njëjlojtë e asnjë të ngjashëm, porse Ai është i Adhuruari i Vërtetë. Kurse mushrikët (idhujtarët) i bënin idhujt, xhindët dhe melaiket të barabartë, të njëjtë e të ngjashëm me Allahun, i adhuronin në vend të Atij dhe kërkonin ndihmë prej tyre. Kështu, Allahu e refuzoi atë që bënin ata dhe e bëri të qartë se këto krijesa nuk kanë asnjë të drejtë që të adhurohen dhe as nuk posedojnë ndonjë fuqi për të bërë diçka, përveç se me Lejen dhe Caktimin e Allahut të Përsosur e të Pastër nga çdo e metë.

³⁵ Ka thënë el-Hafidh Ibn Kethir, Allahu pastë mëshirë për të, në Tefsirin e tij: "Krijuesi i këtyre gjërave" - siç është qielli, toka, frutat, pemët, shiut etj., Ai është Merituesi i adhurimit, i Përsosuri, i Pastru dhe i Larti nga çdo e metë, dhe Ai meriton që t'i bindesh, ngase Ai është Zoti dhe Krijuesi i të gjithëve. Sikurse ka thënë i Lartësuar: "Dhe i adhuruari juaj është një, s'ka të adhuroar tjetër me të drejtë pos Atij, i Gjithëmëshirëshmi, Mëshirëploti." [el-Bekarah, 163]

Dhe llojet e adhurimit³⁶ që ka urdhëruar Allahu janë:

³⁶ Adhurimi është disa llojesh: prej atyre llojeve është Islami me shtyllat e tij. Dhe çdo vepër e Islamit të cilën e ka urdhëruar Allahu është adhurim, siç është namazi, agjërimi e të tjera. E po kështu është edhe Imani me veprat e fsehta, siç është besimi në Allahun, në Melaiket e Tij, në Librat e Tij, në të Dërguarit e Tij, në Ditën e Gjykimit, besimi në Kaderin dhe në të mirën dhe të keqen që vjen prej tij, gjithashtu frika, dashuria, shpresa etj. Pra, çdo gjë që lidhet me zemrën hyn tek adhurimi, madje adhurimi i zemrës është lloji më i lartë e më madhështor nga të gjitha llojet e adhurimit. Kështu që, detyra e çdo njeriu që është i ngarkuar me detyrat sheriatike është që ta bëjë adhurimin me sinqeritet për Allahun të vetëm e të mos u lutet krahas Allahut pejgamberëve, as njerëzve të mirë që kanë vdekur, as idhujve, as pemëve dhe as gurëve, ngase adhurimi është e drejtë e Allahut të vetëm. Ka thënë i Lartësuar: **“Xhamitë i janë kushtuar vetëm Allahut, prandaj mos iu lutni askujt, krahas Allahut!”** Dhe ka thënë i Lartësuar: **“Ty të vetëm të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojnë.”** Dhe ka thënë i Lartësuar: **“Andaj mos iu lut në vend të Allahut atij që as të bën dobi e as të dëmton! E nëse e bën, atëherë s’ka dyshim që do të jesh prej zullumqarëve.”** [Junus, 106] Dhe ka thënë i Përsosuri, i Pastri e i Larti nga çdo e metë: **“E ai që u lutet të tjerëve krahas Allahut s’ka asnjë argument për këtë, por gjithësesi llogaria e tij është tek Allahu. E s’ka dyshim që mosbesimtarët s’kanë për të shpëtuar.”** [el-Mu`minun, 117] Dhe ka thënë Allahu *‘Azze ue Xhelle*: **“Ai është Allahu, Zoti juaj. Pushteti është i Tij! Kurse ata që ju i adhuron krahas Tij, nuk zotërojnë as sa cipa e bërthamës së hurmës. Nëse ju u luteni atyre, ata nuk e dëgjojnë lutjen tuaj, por edhe sikur ta dëgjonin, nuk do t’ju përgjigjeshin. Në Ditën e Kiametit, ata do ta mohojnë shirkun (lutjen) që u bënit atyre. Askush nuk mund të të njoftojë ty (o Muhamed) ashtu si Ai që është i Gjithëdijshëm.”** [Fatir, 13-14] Pra, i Përsosuri nga çdo e metë e quajti lutjen e tyre shirk. Kështu që, detyra e çdo njeriu që është i ngarkuar me detyrat sheriatike është që ta bëjë adhurimin me sinqeritet për Allahun të vetëm, siç është shpresa, kërkimi i ndihmës, kërkimi i shpëtimit, kurhani, zotimi, frikërespekti, namazi, agjërimi, që të gjitha të jenë vetëm për Allahun, si dhe të gjitha llojet e tjera të adhurimit të jenë vetëm për Allahun. Dhe kush i afrohet dikujt tjetër në vend të Allahut, ndonjë njeriu të mirë që ka vdekur apo ndonjë profeti apo ndonjë idhulli apo ndonjë peme apo ndonjë guri, me lutje apo me kurban apo me zotim apo me namaz apo me agjërime apo me

Për shembull Islami, Imani dhe Ihsani. Ë po ashtu është edhe lutja (*ed-Du'a*), frika (*el-Khaf*), shpresa (*er-Rraxhaa*), mbështetja (*el-Teuekkuf*), shpresa në shpërblimin e Allahut (*er-Rragheb*), frika e tmerrshme nga dënimi i Allahut (*er-Rrahbeh*), përulja (*el-Khusbue*), frikërespekti (*el-Khashijeh*), kthimi (*el-Inabeh*), kërkimi i ndihmës (*el-Isti'aneh*), kërkimi i mbrojtjes nga e keqja (*el-Isti'adheh*), kërkimi i ndihmës në rast vështirësie (*el-Istigatheh*), kurbanit (*edh-Dhebh*), zotimi (*en-Nedhr*).³⁷ si dhe lloje të tjera të adhurimit që ka urdhëruar Allahu, të cilat që të gjitha janë vetëm për Allahun e Cartësuar.

Dhe argumenti është Fjala e të Cartësuarit:

﴿وَأَنَّ الْمَسْجِدَ لِلَّهِ فَلَا تَدْعُوا مَعَ اللَّهِ أَحَدًا﴾

"Xhamitë i janë kushtuar vetëm Allahut, prandaj mos iu lutni askujt, krahas Allahut!" [el-Xhinn, 18]

ndonjë lloj tjetër adhurimi, atëherë ai është mushrik kafir. Ai i ka bërë shirk Allahut dhe adhuroi të tjerë krahas Atij, ashtu siç bënë mushrikët e hershëm që adhuronin varret, pemët, gurët apo idhujt. Prandaj ka thënë Allahu 'Azze ue Xhel-le: "E nëse bëjnë shirk, atyre do t'u asgjësohet ajo që kanë punuar." [el-En'am, 88] Dhe ka thënë i Cartësuarit: "Sigurisht, atij që adhuron tjetërkënd përveç Allahut, Allahu do t'ia ndalojë Xhenetin dhe strehim i tij do të jetë Zjarri." [el-Ma'ideh, 72] Dhe ka thënë Allahu Subhanehu ue Te'ala: "Me të vërtetë, të është shpallur ty (o Muhamed), si dhe atyre që kanë qenë para teje: Nëse i shoqëron Allahut diçka tjetër (në adhurim), me siguri që punët e tua do të zhvlerësohen dhe do të jesh ndër të humburit. Prandaj, adhuro vetëm Allahun dhe bëhu falënderues!" [ez-Zumer, 65-66]

³⁷ Pra, është obligim që të gjitha këto adhurime t'i kushtohen me sinqeritet vetëm Allahut, dhe ai që i kushton dikujt tjetër në vend të Allahut diçka prej adhurimit, qoftë sikur t'ia kushtojë ndonjë idhulli apo ndonjë peme apo ndonjë guri apo ndonjë varri, ai i ka bërë shirk Allahut.

Dhe kush i kushton dikujt tjetër diçka prej adhurimit në vend të Allahut, atëherë ai është mushrik (idhujtar) kafir (mosbesimtar).

Dhe argumenti është Fjala e të Lartësuarit:

﴿وَمَنْ يَدْعُ مَعَ اللَّهِ إِلَهًا آخَرَ لَا بُرْهَانَ لَهُ بِهِ فَإِنَّمَا حِسَابُهُ عِنْدَ رَبِّهِ إِنَّهُ لَا يُفْلِحُ الْكَافِرُونَ﴾

"E ai që u lutet të tjerëve krahas Allahut s'ka asnjë argument për këtë, por gjithësesi llogaria e tij është tek Allahu. E s'ka dyshim që mosbesimtarët s'kanë për të shpëtuar." [el-Mu'minun, II7]³⁸

Dhe në hadith ka ardhur:

"الدُّعَاءُ مَخَّ الْعِبَادَةِ."

"Lutja është esenca e adhurimit."³⁹

³⁸ Për shkak të Fjalës së të Lartësuarit: "E ai që u lutet të tjerëve krahas Allahut s'ka asnjë argument për këtë, por gjithësesi llogaria e tij është tek Allahu. E s'ka dyshim që mosbesimtarët s'kanë për të shpëtuar." Si dhe për shkak të ajeteve të tjera që u përmendën më përpara, dhe ky është argument për atë që u tha më lart.

³⁹ Ka ardhur në hadith: "Lutja është esenca e adhurimit." Kurse në një transmetim tjetër ka ardhur: "Lutja është adhurimi." Dhe ka thënë i Përsosuri nga çdo e metë: "Zoti juaj ka thënë: "Lutmuni Mua, se do t'ju përgjigjem! Me të vërtetë, ata që tregohen mendjemëdhenj e nuk duan të Më adhurojnë, do të hyjnë në Xhehenem të poshtëruar!" Pra, Ai e quajti lutjen adhurim në Fjalën e Tij: "...do t'ju përgjigjem! Me të vërtetë, ata që tregohen mendjemëdhenj..." - domethënë tregohen mendjemëdhenj që të më luten Mua. Lutja (*ed-du'a*) është të përlësh veten para Allahut duke i lutur Atij, duke kërkuar shpëtimin nga Ai, duke kërkuar rrëskun nga Ai, e gjithë kjo është adhurim. E nëse njeriu ia kushton këtë lloj adhurimi ndonjë idhulli apo ndonjë peme apo ndonjë guri apo ndonjë të vdekuri, ai i ka bërë shirk Allahut 'Azze ue Xhel-le. Prandaj është obligim që ta paralajmërohet kundër të

gjitha formave të shirkut, i vogël apo i madh, në mënyrë që adhurimi të jetë i gjithi vetëm për Allahun. Mirëpo, nëse i kërkon ndihmë të gjallit, atij që është i pranishëm dhe ka mundësi të të ndihmojë në atë që i kërkon, këtu s'ka ndonjë gjë të keqe dhe kjo nuk hyn tek shirku. Për shembull, nëse i thua vëllait tënd që është prezent: O rob i Allahut më ndihmo që ta pres pemën apo që të bëj një pus, në këtë rast nuk ka ndonjë gjë të keqe, sikurse ka thënë i Përsosuri nga çdo e metë në ngjarjen e Musait: **“Ai i grupit të vet i kërkoj ndihmë kundër atij të popullit armik.”** [el-Kasas, 15] Çifuti i kërkoj ndihmë Musait kundër atij kobtit, sepse Musai kishte mundësi që ta ndihmonte atë kundër atij dhe sepse Musai fliste e dëgjonte. Ama po t'i mbështetesh krijesës për diçka që ai s'ka mundësi të të ndihmojë, përveç Allahut, qoftë ajo krijesë e pranishme apo jo e pranishme apo e vdekur, dhe njeriu beson se ka dobi apo dëm nga lutja që i bën asaj krijese, pa patur asnjë shkak të prekshëm, atëherë ky është shirk ndaj Allahut. Sikurse ka thënë i Lartësuar i për ata që thanë: **“Ata janë ndërmjetësuesit tanë tek Allahu.”** [Junus, 18] Pra, ata mendojnë se duke i adhuruar ato krijesa, ato do të ndërmjetësojnë për ta tek Allahu që të arrijnë plotësimin e kërkesave të tyre ose që ato t'i afrojnë akoma më shumë tek Allahu. Sikurse ka thënë për ta Allahu i Përsosur nga çdo e metë në ajetin tjetër: **“Ne nuk i adhurojmë ato përveç se që të në afrojnë akoma më shumë tek Allahu.”** [ez-Zumer, 3] Dhe ky është rezultati i injorancës dhe devijimit të tyre për sa i përket ndërmjetësuesit dhe atij për të cilin bëhet ndërmjetësimi. Porse i gjithë ndërmjetësimi i takon Allahut *Subhanchu ue Te'ala*, Ai i vendos robërit të Tij ku të dojë Ai dhe nuk ia jep të drejtën e ndërmjetësin askujt tjetër pos atij që Allahu është i kënaqur me punën e tij. Dhe askush nuk ndërmjetëson tek Allahu përveç se pasi të ketë marrë leje prej Tij, sikurse ka thënë i Lartësuar i: **“Kush mund të ndërmjetësojë tek Ai pa lejen e Tij?”** [el-Bekarah, 255] Dhe ka thënë i Lartësuar i: **“E nuk ndërmjetësojnë përveç se për atë me të cilin Ai është i kënaqur.”** [el-Enbija', 28] Pra, ndërmjetësimi ndodh veçse atëherë kur Ai i jep leje ndërmjetësuesit dhe është i kënaqur me atë për të cilin do të ndërmjetësohet. Dhe i Përsosuri nga çdo e metë kënaqet vetëm me ndërmjetësimin për njerëzit e Teuhidit, sikurse ka ardhur në transmetim të saktë nga Pejgamberi (*sal>Allahu 'alejhi ue sellem*) se kur e pyeti Ebu Hurejrah: “Kush është njeriu më i lumtur me ndërmjetësimin tënd o i Dërguari i Allahut?” Ai tha: **“Ai që thotë La ilahe illAllah me sinqeritet nga zemra e tij.”** E ka transmetuar Bukhari në Sahihun e tij. Pra, ndërmjetësimi (*esh-Shefa'ah*) do të jetë vetëm për njerëzit e Teuhidit dhe Imanit, dhe që fjalët e veprat e tyre e kënaqin Allahun.

Dhe argumenti është Fjala e të Lartësuarit:

﴿وَقَالَ رَبُّكُمْ ادْعُونِي أَسْتَجِبْ لَكُمْ إِنَّ الَّذِينَ يَسْتَكْبِرُونَ عَنْ عِبَادَتِي

سَيَدْخُلُونَ جَهَنَّمَ دَاخِرِينَ ﴿٦٠﴾﴾

“Zoti juaj ka thënë: “Utmoni Mua, se do t’ju përgjigjem! Me të vërtetë, ata që tregohen mendjemëdhenj e nuk duan të Më adhurojnë, do të hyjnë në Xhehenem të poshtëruar!” [Gafir, 60]

✿ Dhe argumenti i frikës është Fjala e të Lartësuarit:⁴⁰

⁴⁰ E prej llojeve të adhurimit është frika (*el-Khauf*), dhe ajo është tre llojshë: E para: frika e fshehtë, dhe kjo është e veçantë vetëm për Allahun sepse Ai është i Plotëfuqishëm për gjithçka dhe Atij i duhet patur frikë e tmerr. Sikurse ka thënë i Lartësuari: “Prandaj mos iu frikësoni atyre por frikësoni Mua, nëse jeni besimtarë.” [Aali-Imran, 175] Dhe ka thënë i Lartësuari: “...e që nuk i frikësohen askujt, përveç Allahut.” [et-Teubeh, 18] Dhe ka thënë i Lartësuari: “Prandaj, mos kini frikë nga njerëzit, por kini frikë vetëm prej Meje!” [el-Ma`ideh, 44] Pra, është obligim që të kesh tmerr e frikë nga Allahu sepse Ai i rrotullon zemrat dhe e ndryshon gjendjen e saj, sepse Ai është i Plotëfuqishëm për gjithçka, sepse Ai të bën dobi ose dëm, Ai të jep ose të privon. Prandaj është obligim që Allahu të veçohet me këtë frikë dhe që të mos i frikësohesh askujt tjetër me këtë frikë pos Allahut, për të gjitha çështjet. Duhet që frika e fshehtë të jetë vetëm për Allahun e Përsosur nga çdo e metë. Dhe kjo frikë është atëherë kur njeriu frikësohet nga një fuqi e veçantë, e fshehtë, e cila nuk mund të perceptohet. Dhe kjo është arsyeja përse adhuruesit e varreve besojnë se disa njerëz kanë fuqi që të lëvizin universin krahas Allahut të Madhërishëm e të Lartë, si dhe besojnë se këtë fuqi e kanë idhujt, xhindët e të tjerë veç tyre. Dhe pikërisht ky është shirku i madh. Gjithashtu, ata besojnë se ata (idhujt, xhindët, të vdekurit...) kanë fuqi që të japin ose të të privojnë, kanë fuqi që t’i devijojnë zemrat, kanë fuqi që të të japin vdekjen. Ata i besojnë të gjitha këto pa patur ndonjë shkak të prekshëm apo të perceptueshëm (porse ky besim i tyre është i gjithi besëtytni dhe supersticion i pabazë). E dyta është frika nga shkaqe të prekshme e reale, sikurse ka thënë i Lartësuari në ngjarjen kur i thanë Pejgamberit (*sal-Allahu ‘alejhi ue sellem*): “Me të vërtetë mushrikët (idhujtarët) janë bashkuar kundër

﴿فَلَا تَخَافُوهُمْ وَخَافُوا رَبَّكَ إِن كُنتُمْ مُؤْمِنِينَ﴾

“Prandaj mos iu frikësoni atyre por frikësoni Mua, nëse jeni besimtarë.” [Aali-Imran, 175]

jush dhe do t’ju sulmojnë.” Atëherë, Allahu zbriti ajetin: “Në të vërtetë shejtani i frikëson ithtarët e vet, prandaj mos iu frikësoni atyre por frikësoni Mua, nëse jeni besimtarë.” [Aali-Imran, 175] Pra, shejtani i frikëson njerëzit nga ithtarët e tij dhe i egzagjeron ata në zemrat e njerëzve derisa ata të kenë frikë prej tyre. Kurse Allahu thotë: “...prandaj mos iu frikësoni atyre...” por mbështetuni tek Unë dhe përgatituni kundër tyre dhe mos ua vini veshin atyre, sikurse ka thënë i Lartësuari: “**Andaj përgatisni forcë kundër tyre sa të keni mundësi...**” [el-Enfal, 60] Dhe s’ka ndonjë gjë të keqe tek kjo frikë nga rreziku i perceptueshëm, mirëpo frika që është e ndaluar është frika e zemrës që është frikë e fshehtë. Kurse frika nga rreziku apo e keqja e perceptueshme është për shembull kur frikësohesh nga grabitësi apo nga hajduti apo nga armiku. Në këtë mënyrë përgatit armët e domosdoshme për t’u mbrojtur. Prandaj i Lartësuari ka thënë: “**O ju që besoni përgatituni dhe merrni të gjitha masat...**” [en-Nisa`, 71] Dhe ka thënë i Përsosuri nga çdo e metë në ngjarjen e Musait kur doli nga Egjipti i frikësuar nga Faraoni dhe populli i tij: “**Musai doli prej qytetit i frikësuar, duke pritur se ç’do të ndodhte...**” [el-Kasas, 21] Sepse në të vërtetë kjo frikë është nga një rrezik i prekshëm, real, dhe nuk ka gjë të keqe në të. Mirëpo nuk lejohet t’i frikësohesh armikut me një frikë që të ndalon nga xihadi dhe të ndihmuarit e hakut, porse duhet që kjo frikë të shtyjë në përgatitjen dhe marrjen e masave të domosdoshme kundër armikut. E treta është frika e natyrshme me të cilën karakterizohet njeriu, dhe tek kjo nuk ka gjë të keqe, siç është për shembull frika e njeriut nga gjarpri apo akrepi, kështu ai distancohet nga ato dhe i vret, si dhe largohet nga strofulla e egërsirave në mënyrë që të mos rrezikohet e të dëmtohet nga ato. Kjo është diçka e pandryshueshme. Allahu e ka bërë natyrën njerëzore të karakterizohet me frikën nga ato gjëra që e dëmtojnë atë, në mënyrë që ai të marrë masa që të ruhet. Ai ka frikë nga të ftohtit prandaj vesh rroba të trasha, ka frikë nga uria prandaj ushqehet, ka frikë nga etja prandaj pi. Të gjitha këto janë gjëra të natyrshme e s’ka ndonjë gjë të keqe në to.

☀ Dhe argumenti për shpresën (*er-Rraxhaa'*)⁴¹ është Fjala e të Lartësuarit:

﴿فَمَنْ كَانَ يَرْجُوا لِقَاءَ رَبِّهِ فَلْيَعْمَلْ عَمَلًا صَالِحًا وَلَا يُشْرِكْ بِعِبَادَةِ رَبِّهِ أَحَدًا ٥١﴾

"Kështu, kush shpreson takimin me Zotin e vet, le të bëjë vepra të mira dhe të mos i shoqërojë askënd në adhurim Zotit të vet!" [el-Kehf, 110]

☀ Dhe argumenti për mbështetjen (*et-Teuekkul*)⁴² është Fjala e të Lartësuarit:

﴿وَعَلَى اللَّهِ فَتَوَكَّلُوا إِن كُنْتُمْ مُؤْمِنِينَ ٥٢﴾

"Dhe Allahut mbështetjuni nëse jeni besimtarë!" [el-Ma'ideh, 23]

Dhe Ai ka thënë:

⁴¹ Po kështu edhe shpresa (*er-Rraxhaa'*) është adhurim për Allahun. Robi shpreson tek Allahu dhe ka mendim të mirë për Allahun, sikurse ka thënë i Lartësuarit: "Kështu, kush shpreson takimin me Zotin e vet, le të bëjë vepra të mira dhe të mos i shoqërojë askënd në adhurim Zotit të vet!" Pra, malli për Të dhe shpresa në shpërblimin e Tij është adhurim për Allahun *Subhanehu ue Te'ala*. Ka thënë i Lartësuarit: "Me të vërtetë, ata nxitonin për vepra të mira dhe Na luteshin, me shpresë e frikë dhe ishin të përlulur ndaj Nesh." [el-Enbija', 90] "*Er-Rragabeh*" është "*er-Rraxhaa'*", kurse "*er-Rrahbeh*" është "*el-Khauf*", dhe që të dyja janë adhurim. Prandaj robi e ka detyrë që të ketë mendim të mirë për Zotin e tij dhe të bëjë shkaqet sheriatike, sepse mendimi i mirë dhe bërja e shkaqeve i kthehet robit në mirësi, mëshirë, hyrje në Xhenet dhe falje të gjynaheve.

⁴² Po kështu edhe mbështetja (*et-Teuekkul*) është adhurim, dhe ajo është: t'ia besosh çështjen Allahut dhe t'i mbështetesh Atij për të gjitha çështjet, si dhe duke bërë shkaqet. Pra, i mbështetesh Allahut për t'u ruajtur nga e keqja, për të qenë i sigurt nga fitnet, për të arritur furnizimin, për të hyrë në Xhenet dhe për të shpëtuar nga Zjarri, duke bërë shkaqet e ligëruara. Ka thënë i Lartësuarit: "Dhe Allahut mbështetjuni nëse jeni besimtarë!" Dhe ka thënë i Lartësuarit: "Dhe kush i mbështetet Allahut, Ai i mjafton atij."

﴿وَمَنْ يَتَوَكَّلْ عَلَى اللَّهِ فَهُوَ حَسْبُهُ﴾

“Dhe kush i mbështetet Allahut, Ai i mjafton atij.” [el-Ṭalak, 3]

✿ Dhe argumenti i shpresës në shpërblimin e Allahut (*er-Rragbeh*), frikës së tmerrshme nga dënimi i Allahut (*er-Rrabbeh*) dhe përlujes (*el-Khushuë*)⁴³, është Fjala e të ʿArtësuarit:

﴿إِنَّهُمْ كَانُوا يُسْرِعُونَ فِي الْخَيْرَاتِ وَيَدْعُونَنَا رَغَبًا وَرَهَبًا

وَكَانُوا لَنَا حَاشِعِينَ﴾

“Me të vërtetë, ata nxitonin për vepra të mira dhe Na luteshin, me shpresë e frikë dhe ishin të përlulur ndaj Nesh.” [el-ʿEnbija, 90]

✿ Dhe argument i frikërespektit (*el-Khashijeh*) është Fjala e të ʿArtësuarit:

﴿فَلَا تَخْشَوْهُمْ وَاخْشَوْنِي﴾

“...e atyre mos iu frikësoni, frikësohuni vetëm prej Meje.” [el-Bekarah, 150]

✿ Dhe argumenti i kthimit (*el-Inabeh*)⁴⁴ është Fjala e të ʿArtësuarit:

⁴³ Po kështu edhe shpresa “*er-Rragbeh*”, frika e tmerrshme “*er-Rrabbeh*” dhe frikërespekti “*el-Khashijeh*” nga Allahu, që të gjitha këto janë adhurim. Ka thënë i ʿArtësuarit për disa pejgamberë të devotsëm: “Me të vërtetë, ata nxitonin për vepra të mira dhe Na luteshin, me shpresë e frikë dhe ishin të përlulur ndaj Nesh.” – domethënë kishin frikë, i përuleshin Allahut dhe kishin frikë nga Madhëria e Tij, domethënë i ulnin poshtë vetet e tyre.

⁴⁴ Po kështu edhe kthimit (*el-Inabeh*) është adhurim. Ka thënë i ʿArtësuarit: “Kthehuni tek Zoti juaj dhe nënshtrojeni Atij...” Kuptimi i “*el-Inabeh*” është; të kthesh tek Allahu, të pendohesh tek Ai dhe t’i përmbahesh bindjes ndaj Tij, e gjithë kjo është adhurim për Allahun. Njerëzit e kanë detyrë që t’i

﴿وَأَنبِئُوا إِلَىٰ رَبِّكُمْ وَأَسْلِمُوا لَهُ﴾

“Kthehuni tek Zoti juaj dhe nënshtrojuni Atij...” [ez-Zumer, 54]

✿ Dhe argumenti i kërimit të ndihmës (*el-Isti'aneh*)⁴⁵ është Fjala e të Lartësuarit:

﴿إِذَا سَأَلَكَ عِبْدُ وَإِيَّاكَ فَاسْتَجِبْ لَهُ﴾

“Ty të vetëm të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.” [el-Fatihah, 5]

Dhe ka ardhur në hadith:

إِذَا اسْتَعْنَتْ فَاسْتَعِنْ بِاللَّهِ.

“E nëse kërkon ndihmë, kërko vetëm nga Allahu.”

✿ Dhe argumenti i kërimit të mbrojtjes (*el-Isti'adheh*)⁴⁶ është Fjala e të Lartësuarit:

kthehen Allahut, që të pendohen tek Ai dhe që t'i përmbahen bindjes ndaj Tij.

⁴⁵ Po kështu edhe kërkitimi i ndihmës (*el-Isti'aneh*) është adhurim, sikurse ka thënë i Lartësuarit: “Ty të vetëm të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.” Dhe ka ardhur në hadith: “E nëse kërkon ndihmë, kërko vetëm nga Allahu.” Kështu, robi i kërkon ndihmë Allahut dhe thotë: “O Allah më ndihmo të të përkujtoj e të të falenderoj, o Allah më ndihmo të të bindem Ty, o Allah më ndihmo në çdo të mirë”, si dhe për gjëra të tjera. Pra, i kërkon ndihmë Allahut për çdo gjë që të intereson.

⁴⁶ Po kështu edhe kërkitimi i mbrojtjes (*el-Isti'adheh*) është adhurim, që robi të kërkojë mbrojtjen e Allahut nga të këqijat dhe t'i mbështetet Atij, sikurse ka thënë i Lartësuarit: “Thuaj: Kërkoj mbrojtje nga Zoti i agimit.” Dhe Fjala e Tij: “Thuaj: Kërkoj mbrojtje nga Zoti i njerëzve.” Pra, t'i kërkos Allahut të të mbrojë nga Shejtani apo nga çdo gjë e dëmshme apo nga çdo armik, kjo

﴿قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ الْفَلَقِ﴾

“Thuaj: Kërkoj mbrojtje nga Zoti i agimit.” [el-Felek, 1]

Dhe Fjala e të Lartësuarit:

﴿قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ النَّاسِ﴾

“Thuaj: Kërkoj mbrojtje nga Zoti i njerëzve.” [en-Nas, 1]

✿ Dhe argumenti i kërkimit të ndihmës në rast vështirësie (*el-Istigatheh*)⁴⁷ është Fjala e të Lartësuarit:

﴿إِذْ تَسْتَغِيثُونَ رَبَّكُمْ فَاسْتَجَابَ لَكُمْ﴾

“Ju kërkuat ndihmë nga Zoti juaj e Ai ju përgjigj.” [el-Enfal, 9]

✿ Dhe argumenti i kurbanit⁴⁸ është Fjala e të Lartësuarit:

﴿قُلْ إِنْ صَلَاتِي وَنُسُكِي وَمَحْيَايَ وَمَمَاتِي بِرَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿١٦٦﴾ لَا شَرِيكَ لَهُ﴾

“Thuaj: Në të vërtetë, namazi im, kurbanu im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve. Ai nuk ka asnjë ortak.” [el-En'am, 162-163]

është e urdhëruar, siç ka thënë i Lartësuari: “Nëse shejtani përpiqet të të shtyjë drejt së keqes, kërko mbrojtje nga Allahu.” [el-E'araf, 200]

⁴⁷ Edhe kërkimi i ndihmës në rast vështirësie (*el-Istigatheh*) është adhurim, që t'i kërkosh ndihmë Allahut kur je në vështirësi nga armiku ose të kërkosh të bjerësh shi i begatë ose të kërkosh ndihmë për të larguar dëmin. Sikurse ka thënë i Lartësuari: **“Ju kërkuat ndihmë nga Zoti juaj e Ai ju përgjigj.”**

⁴⁸ Po kështu edhe kurbanu (*edh-Dhebh*) është adhurim. Ka thënë i Lartësuari: **“Thuaj: Në të vërtetë, namazi im, kurbanu im”** – domethënë therja e bagëtive – **“jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve.”**

Dhe argumenti nga Suneti është fjala e të Dërguarit (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*):

لَعَنَ اللَّهُ مَنْ ذَبَحَ لِغَيْرِ اللَّهِ.

"E mallkoftë Allahu atë që bën kurban për të tjerë në vend të Allahut."

⚙ **Dhe argumenti i zotimit (*en-Nedhr*)⁴⁹ është fjala e të Lartësuarit:**

﴿يُوفُونَ بِالنَّذْرِ وَخَافُونَ يَوْمًا كَانَ شَرُّهُ مُسْتَطِيرًا﴾

"Ata e zbatojnë zotimin dhe i frikësohen Ditës (së Kiametit), tmerri i së cilës përhapet gjithkund." [el-Insan, 7]

⁴⁹ Po kështu edhe zotimi (*en-Nedhr* – të marrësh përsipër për të bërë një vepër, të japësh fjalën për të kryer një punë) është adhurim. Ka thënë i Lartësuar: "Ata e zbatojnë zotimin". Dhe ka thënë i Lartësuar: "Çfarëdo gjëje që të jepni dhe çdo zotim që të bëni, me siguri që Allahu ka dijeni për atë!" [el-Bekarah, 270] Dhe ka thënë i Dërguari (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*): "Kush është zotuar që t'i bindet Allahut, duhet t'i bindet Atij; dhe kush është zotuar që të mos i bindet Allahut në diçka, duhet që të mos e bëjë atë që është mosbindje ndaj Atij." Pra, zotimi është adhurim dhe bindje për Allahun. Nëse njeriu zotohet, atëherë ai e ka detyrë që ta përmbushë atë. Mirëpo zotimi është i urryer sepse në të ka detyrim dhe vështirësim për vetveten. Prandaj ka ndaluar Pejgamberi (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*) nga zotimi, dhe ka thënë: "Zotimi nuk vjen me mirësi." Porse, nëse njeriu zotohet për të bërë një vepër që është bindje ndaj Allahut, ai obligohet që ta përmbushë zotimin për shkak të fjalës së të Dërguarit (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*): "Kush është zotuar që t'i bindet Allahut, duhet t'i bindet Atij." Kështu që, zotimi (*en-Nedhr*) është adhurim, siç është namazi apo agjërimi apo adhurimet e tjera, dhe është obligim përmbushja e tij, siç u tha më përpara.

Parimi i Dytë: që robi të njohë Fenë Islame me argumente⁵⁰

Islami është: t'i dorëzohesh Allahut me Teuhijd dhe t'i nënshtrohesh Atij duke iu bindur e duke u distancuar nga shirku dhe mushrikunët.

Islami është në tre grada: Islami, Imani dhe Ihsani. Dhe secila gradë ka shtylla.

Shtyllat e Islamit janë pesë⁵¹:

⁵⁰ Ky është parimi i dytë, që është feja Islame. Islami i ka tre grada, të cilat i ka sqaruar i Dërguari (*sal-lAllahu 'alejhi ue sellem*). E para prej tyre është Islami, i cili është: që adhurimi të bëhet i pastër, i sinqertë vetëm për Allahun, domethënë ai është nënshttrim me adhurim për Allahun, ta veçosh Allahun me adhurim duke përjashtuar çdokënd e çdogjë tjetër nga adhurimi, si dhe të distancohesh nga shirku dhe nga mushrikët (ata që i bëjnë shirk Allahut). Nëse njeriu e bën të gjithë këtë, atëherë ai ka hyrë në Islam. Domethënë: të nënshtrohesh, të ulësh veten tënde dhe të përulesh për Allahun të vetëm me adhurim, dhe për askënd e asgjë tjetër pos Atij, si dhe të distancohesh nga shirku dhe nga mushrikët. Ka thënë i Lartësuar: **"Ai që mohon tagutët dhe beson Allahun është kapur në lidhjen më të fortë..."** [el-Bekarah, 256] Domethënia e mohimit të tagutëve është: të distancohesh nga shirku dhe nga mushrikët, t'i refuzosh ato dhe të besosh se ato janë të pavlera. Pastaj vjen grada e Imanit dhe grada e Ihsanit. Të gjitha këto hyjnë tek feja Islame, feja të cilën e ligjëroi Allahu për robërit e Tij dhe me të cilën i dërgoi të gjithë të Dërguarit. Grada e Islamit përfshin veprat e dukshme.

⁵¹ Shtyllat e Islamit janë pesë: Dëshmia **La ilahe il-Allah, Muhammedun Rasul-lullah**; falja e namazit; dhënia e zekatit; agjërimi i Ramadanit; dhe haxhi në Shtëpinë e Shenjtë për atë që ka mundësi. Sikurse është vërtetuar nga Pejgamberi (*sal-lAllahu 'alejhi ue sellem*) se ai ka thënë: **"Islami është ndërtuar mbi pesë: dëshmia **La ilahe il-Allah**; falja e namazit; dhënia e zekatit; agjërimi i Ramadanit; dhe haxhi në Shtëpinë e Shenjtë."** Shtylla e parë e Islamit është dëshmia **La ilahe il-Allah** dhe me të robi hyn në Islam, duke dëshmuar **"La**

ilahe il-Allah", domethënë: duke dëshmuar se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë pos Allahut. Dhe kjo dëshmi përmban një mohim dhe një pohim. Tek pjesa "La ilahe" ka mohim, kurse tek pjesa "il-Allah" ka pohim. Ka thënë i Lartësuari: "Ty të vetëm të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë." Dhe ka thënë i Lartësuari: "Dhe ata nuk u urdhëruan përveç se që ta adhuronin Allahun me sinqeritet duke ia dedikuar Fenë vetëm Atij." Dhe ka thënë i Lartësuari: "Kjo është kështu, sepse Allahu është e Vërteta (i vetmi që meriton të adhurohet), kurse gjithçka që adhurohet përveç Tij, është e pavërteta." [el-Haxh, 62] Ama, që kjo dëshmi të thuhet pa punuar me të, ajo s'të bën dobi. Si për shembull: të thuhet "**La ilahe il-Allah**" dhe të mos veçohet Allahu me adhurim, në këtë rast thënia e dëshmisë nuk ka dobi. Njësoj si munafikët, ngase ata e thonin dëshminë porse nuk e besonin atë, prandaj ata janë në shkallën më të fundit të Zjarrit të Xhehenemit. Pra, ai që thotë "**La ilahe il-Allah**" dhe adhuron varret dhe idhujt, atij nuk i bën dobi thënia e dëshmisë, porse thënia e saj është e pavlerë. Ndërsa për dëshminë e dytë, që është "**Muhamedun Rasulullah**", argumenti i saj është Fjala e të Lartësuarit: "**Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj.**" - domethënë: ju e njihni Muhamedin (*'alejhis-salatu ues-selam*), sepse ai është nga gjiri juaj dhe ai është nga fiset tuaja më fisnike, nga fisi Beni Hashim. "**Atij i vjen rëndë për hallet tuaja**" - domethënë: ai rëndohet nga ato gjëra që ju rëndojnë juve. "**jua dëshiron të mirën me gjithë zemër dhe përpiqet që ju të shkoni rrugës së drejtë**" - domethënë: përpiqet t'ju udhëzojë e t'ju shpëtojë nga Zjarri i Xhehenemit. Dhe ka thënë i Lartësuari: "**Muhamedi është i Dërguari i Allahut.**" Dhe pas kësaj dëshmie, robi e ka detyrë që t'i bindet të Dërguarit në urdhërat e tij, t'i besojë lajmet që ka sjellë ai dhe të qëndrojë larg nga gjërat që ai i ka ndaluar dhe i ka qortuar, si dhe ta adhurojë Allahu veçe sipas mënyrës që ka përshkruar ai. Pra, këto katër çështje janë të domosdoshme:

E para: t'i bindesh atij në urdhërat e tij, siç është namazi, zekati etj.

E dyta: të besosh lajmet që solli ai rreth Ahiretit, Xhenetit, Xhehenemit etj.

E treta: të largohesh nga ato që ka ndaluar dhe ka qortuar ai, siç është zinaja, kamata dhe të gjitha ato gjëra që i ka ndaluar Allahu dhe i Dërguari i Tij.

E katërta: që ta adhurosh Allahun veçe sipas mënyrës që ka përshkruar ai, si dhe të mos shpikësh në fe gjëra të cilat nuk i ka ligjëruar Allahu, për shkak se Pejgamberi (*sal-Allahu 'alejhi ue sel-lem*) ka thënë: "Kush bën një vepër të cilën ne nuk e kemi urdhëruar, ajo është e refuzuar." Kurse në një transmetim tjetër ka ardhur: "Kush shpik në këtë çështjen tonë diçka që nuk është prej saj, ajo është e refuzuar." Domethënë ajo hidhet poshtë.

dëshmia “**لا إله إلا الله، محمد رسول الله**”, falja e namazit, dhënia e zekatit⁵², agjërimi i Ramadanit⁵³ dhe haxhi në Shtëpinë e Shenjtë të Allahut.⁵⁴

❁ Argumenti për dëshminë⁵⁵ është Fjala e të Lartësuarit:

﴿شَهِدَ اللَّهُ أَنَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ وَالْمَلَائِكَةُ وَأُولُو الْعِلْمِ قَابًا مَّا بِالْقِسْطِ

لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ ﴿١٨﴾

“Allahu dëshmon, e po ashtu edhe engjëjt, edhe njerëzit e dijes, se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Tij, duke mbajtur drejtësinë. S’ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Atij, të Plotfuqishmit, të Urtit.” [Aali-Imran, 18]

⁵² Argumenti për namazin, zekatin dhe shpjegimin e Teuhidit është Fjala e të Lartësuarit: “Dhe ata nuk u urdhëruan përveç se që ta adhuronin Allahun me sinqeritet duke ia dedikuar Fenë vetëm Atij, të jenë Hunefa (në fenë e Ibrahimit), si dhe të falin namazin e të japin zekatin. Kjo është feja e drejtë.” Dhe ka thënë i Lartësuarit: “Megjithatë, nëse ata pendohen, falin namazin dhe japin zeqatin, atëherë janë vëllezërit tuaj në fe.” [et-Teubeh, 11] Dhe ka thënë i Lartësuarit: “Por, nëse pendohen, falin namazin dhe japin zeqatin, atëherë i lini të qetë!” [et-Teubeh, 5]

⁵³ Argumenti për agjërimin është Fjala e të Lartësuarit: “O besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu si u ishte urdhëruar atyre para jush.” [el-Bekarah, 183] – e deri tek Fjala e Tij: “Muaji i Ramadanit...” [el-Bekarah, 183-185] Domethënë që agjërimi është obligim për ju çdo vit, në muajin e Ramadanit.

⁵⁴ Argumenti për haxhin është Fjala e të Lartësuarit: “Dhe për Allahun është vizita (për haxh) e Shtëpisë së Shenjtë, e cila është detyrë për çdo njeri që ka mundësi ta përballojë rrugën. E kush nuk beson, Allahu nuk ka nevojë për askënd.” [Aali-Imran, 97] Dhe haxhi është detyrë që të kryhet një herë në jetë, për shkak të fjalës së të Dërguarit (*sal-lAllahu ‘alejhi ue sellem*): “Haxhi është vetëm një herë; kush shton mbi këtë e ka haxh vullnetar.”

⁵⁵ E përmendëm më herët shpjegimin për këtë faqe dhe për faqen që vijon mbas kësaj.

Dhe kuptimi i dëshmisë [**La ilahe il-Allah**] është: s'ka të adhuroar tjetër me hak, me të drejtë përveç Allahut.

La ilahe: kjo pjesë e dëshmisë mohon gjithçka që adhurohet në vend të Allahut.

il-Allah: kurse kjo pohon adhurimin për Allahun të vetëm e të paortakë në adhurimin e Tij, ashtu siç nuk ka Ai ortakë në sundimin e Tij.

☀ Dhe shpjegimi i dëshmisë ku sqarohet mohimi dhe pohimi i saj ka ardhur në Fjalën e të Cartësuarit:

﴿وَإِذْ قَالَ إِبْرَاهِيمُ لِأَبِيهِ وَقَوْمِهِ إِنَّنِي بَرَاءٌ مِّمَّا تَعْبُدُونَ ﴿٢٥﴾ إِلَّا الَّذِي فَطَرَنِي فَإِنَّهُ

سَيِّدِي ﴿٢٦﴾ وَجَعَلَهَا كَلِمَةً بَاقِيَةً فِي عَقْبِهِ ﴿٢٧﴾ لَعَلَّهُمْ يَرْجِعُونَ ﴿٢٨﴾﴾

"(Kujto) kur Ibrahim i tha babait dhe popullit të tij: "Në të vërtetë, Unë distancohem dhe jam i pastër nga ato që adhuroni ju. [Unë nuk adhuroj asnjë nga ato] përveç Atij, që më ka krijuar dhe i Cili do të më udhëzojë në rrugën e drejtë". Ai e bëri këtë fjalë të përbërshme te pasardhësit e tij, me qëllim që ata të kthehen (vazhdimisht tek Allahu)." [ez-Zukhruf, 26-28]

Dhe në Fjalën e të Cartësuarit:

﴿قُلْ يٰٓأَهْلَ ٱلْكِتَٰبِ تَعَالَوْا۟ إِلَىٰ كَلِمَةٍ سَوَآءٍ بَيْنَنَا وَبَيْنَكُمْ أَلَّا نَعْبُدَ إِلَّا ٱللَّهَ وَلَا

نُشْرِكُ بِهِ شَيْئًا وَلَا يَتَّخِذَ بَعْضُنَا بَعْضًا أَرْبَابًا مِّن دُونِ ٱللَّهِ فَإِن تَوَلَّوْا۟ فُقُولُوا۟

أَشْهَدُوا۟ بِأَنَّا مُسْلِمُونَ ﴿١٠٨﴾﴾

"Thuaj: "O ithtarët e Librit, ejani të biem në një fjalë të përbashkët mes nesh dhe jush: se do të adhurojmë vetëm Allahun, se nuk do t'i shoqërojmë Atij asgjë (në adhurim) dhe se nuk do ta mbajmë për zot njëri-tjetrin, në vend të Allahut!" Nëse ata nuk

pranojnë, atëherë thoni: “Dëshmoni se ne i jemi nënshtruar Allahut!” [Ali-Imran, 26-28]

☀ Dhe argument për dëshminë “Muhammedun Rasul-lullah” është Fjala e të Ƨartësuarit:

﴿لَقَدْ جَاءَكُمْ رَسُولٌ مِّنْ أَنْفُسِكُمْ عَزِيزٌ عَلَيْهِ مَا عَنِتُّمْ حَرِيصٌ عَلَيْكُمْ

بِالْمُؤْمِنِينَ رَءُوفٌ رَّحِيمٌ ﴿٢٨﴾

“Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për hallat tuaja, jua dëshiron të mirën me gjithë zemër dhe përpiqet që ju të shkoni rrugës së drejtë dhe është i butë e i mëshirshëm me besimtarët.” [et-Ƨeubeh, 128]

Dhe kuptimi i dëshmisë “Muhammedun Rasul-lullah” është: ti bindesh urdhërit të tij, të pohosh lajmet që ka sjellë ai, të qëndrosh larg gjërave që ka ndaluar ai dhe të adhurosh Allahun veçse me atë që ka ligjëruar ai.

☀ Dhe argument për namazin, zekatin dhe shpjegimin e Ƨeuhidit është Fjala e të Ƨartësuarit:

﴿وَمَا أُمِرُوا إِلَّا لِيَعْبُدُوا اللَّهَ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ حُنَفَاءَ وَيُقِيمُوا الصَّلَاةَ وَيُؤْتُوا

الزَّكَاةَ وَذَلِكَ دِينُ الْقَيِّمَةِ ﴿٥﴾

“E megjithatë, ata qenë urdhëruar vetëm që të adhuronin Allahun me përkushtim të singertë, duke qenë Hunefaa (në fenë e pastër të Ibrahimit), si dhe të falnin namazin e të jepnin zeqatin. Kjo është feja e drejtë.” [el-Bejjineh, 5]

☀ Dhe argument për agjërimin është Fjala e të Ƨartësuarit:

﴿يَتَأْتِيهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا كُتِبَ عَلَيْكُمُ الصِّيَامُ كَمَا كُتِبَ عَلَى الَّذِينَ مِن قَبْلِكُمْ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ﴾

“O besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu si u ishte urdhëruar atyre para jush, që të mund të bëheni të devotshëm (duke zbatuar urdhërat e Allahut e duke u larguar nga ndalesat e Tij).” [el-Bekarah, 183]

✿ Dhe argument për haxhin është Fjala e të Cartësuarit:

﴿وَلِلَّهِ عَلَى النَّاسِ حِجُّ الْبَيْتِ مَنِ اسْتَطَاعَ إِلَيْهِ سَبِيلًا
وَمَن كَفَرَ فَإِنَّ اللَّهَ غَنِيٌّ عَنِ الْعَالَمِينَ﴾

“Dhe për Allahun është vizita (për haxh) e Shtëpisë së Shenjtë, e cila është detyrë për çdo njeri që ka mundësi ta përballojë rrugën. E kush nuk beson, Allahu nuk ka nevojë për askënd.” [Ali-Imran, 97]

Grada e dytë është Imani.⁵⁶

⁵⁶ Imani është ai që lidhet me zemrën, siç është pohimi i ekzistencës së Allahut, pohimi që Ai është Zoti i të gjitha botëve, se Ai e meriton adhurimin, të pohosh ekzistencën e Melaikeve, Librave, të Dërguarve, ringjalljen mbas vdekjes, Xhenetin dhe Xhehenemin, Kaderin, si dhe të mirën e të keqen që vjen me të. Të gjitha këto lidhen me zemrën dhe këto janë baza themelore të domosdoshme, dhe s'ka Islam pa Iman dhe s'ka Iman pa Islam. Kështu që, duhet patjetër që të jenë të dyja këto, duhet patjetër që të jetë Islami i gjymtyrëve, duhet patjetër që të jetë Islami i zemrës me Imanin e tyre. Prandaj Allahu i ka vendosur bashkë të dyja këto çështje në Librin e Tij madhështor, e po kështu edhe i Dërguari (*sal-Allahu 'alejhi ue sel-lem*) i ka përmendur ato të dyja së bashku. Islami është nënshtrimi i shfaqur me bindjen për Allahun dhe

Dhe ai është shtatëdhjetë e disa degë. Më e larta prej tyre është fjala “**La ilahe il-Allah**”, kurse më e ulta është largimi i pengesës nga rruga. Edhe turpi është një degë e Imanit.

Shtyllat e Imanit janë gjashtë: të besosh në Allahun, në Melaiket e Tij, në Librat e Tij, në të Dërguarit e Tij, në Ditën e Kijametit, në Kaderin dhe në të mirën e të keqen që vjen prej tij.

Dhe argumenti për këto gjashtë shtylla është Fjala e të Lartësuarit:

﴿لَيْسَ الْبِرُّ أَنْ تُولُوا وُجُوهَكُمْ قِبَلَ الْمَشْرِقِ وَالْمَغْرِبِ وَلَكِنَّ الْبِرَّ مَنْ ءَامَنَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ
الْآخِرِ وَالْمَلَائِكَةِ وَالْكِتَابِ وَالنَّبِيِّينَ﴾

“Mirësia nuk është të kthyerit e fytyrës suaj nga lindja dhe perëndimi, por mirësia është (cilësi) e atij që beson Allahun, Ditën e Fundit, Melaiket, Librin dhe Pejgamberët.” [el-Bekarah, 177]

Dhe argument për Kaderin është Fjala e të Lartësuarit:

braktisjen e mos-bindjes ndaj Tij, kurse Imani përfshin veprat e fshehta të cilat lidhen me zemrën dhe pohimin e saj. Islami përdoret edhe me kuptimin e Imanit dhe Imani përdoret edhe me kuptimin e Islamit. Nëse përmendet Imani, ai i përfshin të gjitha, e nëse përmendet Islami, edhe ai i përfshin të gjitha. Ka thënë i Lartësuari: **“Me të vërtetë Feja e pranuar tek Allahu është Islami.”** [Aali-Imran, 19] Pra, ai përfshin atë që lidhet me të fshehtë dhe atë që lidhet me të shfaqurën. E po kështu është edhe Imani: nëse përmendet, ai i përfshin të gjitha, për shkak të fjalës së Pejgamberit (*sal-lAllahu ‘alejhi ue sellem*) në hadithin e saktë: **“Imani është shtatëdhjetë e disa degë. Më e larta prej tyre është fjala “La ilahe il-Allah”, kurse më e ulta është largimi i pengesës nga rruga.”** Pra, Imani këtu i përfshin të gjitha, përfshin shtyllat e Islamit, përfshin veprat e shfaqura, ashtu siç përfshin ato të fshehtat dhe siç përfshin edhe Ihsanin.

﴿إِنَّا كُلَّ شَيْءٍ خَلَقْنَاهُ بِقَدَرٍ ﴿٥١﴾﴾

“Me të vërtetë që Ne çdo gjë e kemi krijuar me Kader (me paracaktim).” [el-Kamer, 49]

Grada e tretë është Ihsani.⁵⁷ Ai ka vetëm një shtyllë, e cila është: “Që ta adhurosh Allahun sikur e sheh Atë, por edhe pse nuk e sheh Atë, s’ka dyshim se Ai të shikon ty.”

Dhe argumenti është Fjala e të Lartësuarit:

﴿إِنَّ اللَّهَ مَعَ الَّذِينَ اتَّقَوْا وَالَّذِينَ هُمْ مُحْسِنُونَ ﴿١٥٨﴾﴾

“Vërtet, Allahu është me ata që e kanë frikë dhe që janë muhsininun (punëmirë).” [en-Nahl, 128]

Dhe Fjala e të Lartësuarit:

﴿وَتَوَكَّلْ عَلَى الْعَزِيزِ الرَّحِيمِ ﴿١٠٢﴾ الَّذِي يَرِنُكَ حِينَ تَقُومُ ﴿١٠٣﴾ وَتَقَلُّبِكَ فِي السَّجْدَيْنِ ﴿١٠٤﴾ إِنَّهُ هُوَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ ﴿١٠٥﴾﴾

⁵⁷ Kurse Ihsani është përsosja e adhurimit haptazi dhe fshehurazi. Ihsani është që ta adhurosh Allahun sikur ti po e shikon Atë, por edhe pse ti nuk e shikon Atë, Ai të shikon ty. Dhe kush e adhuron Allahun me këtë ndjenjë ka arritur gradën e Ihsanit dhe tek ai është tubuar e gjithë mirësia. Sikurse ka thënë i Lartësuarit: “Vërtet, Allahu është me ata që e kanë frikë dhe që janë muhsininun (punëmirë).” Dhe ka thënë Allahu ‘Azze ue Xhele: “Vërtet, mëshira e Allahut është afër muhsininunëve (punëmirëve).” [el-E’araf, 56] Dhe ajetet me këtë kuptim janë të shumta.

“Dhe mbështetu në të Plotfuqishmin, Mëshirëplotin, i Cili e sheh qëndrimin tënd në këmbë (gjatë namazit), dhe lëvizjet e tua midis atyre që përuhen në sexhde.” [esh-Shu’araa’, 217-220]

Dhe Fjala e të Cartësuarit:

﴿وَمَا تَكُونُ فِي شَأْنٍ وَمَا تَتْلُوا مِنْهُ مِنْ قُرْآنٍ وَلَا تَعْمَلُونَ مِنْ عَمَلٍ
إِلَّا كُنَّا عَلَيْكُمْ شُهُودًا إِذْ تُفِيضُونَ فِيهِ﴾

“Në çfarëdo pune që të jesh, çfarëdo gjëje që të lexosh nga Kurani dhe çfarëdo pune që të bëni (o njerëz), Ne jemi dëshmitarë, kur ju të thelloheni në të.” [Junus, 61]

Dhe argumenti nga Suneti është hadithi i famshëm i Xhibrilit, të cilin e ka transmetuar ‘Umeri (*radij-Allahu ‘anhü*).

Ai ka thënë:

“Një ditë, kur ishim ulur me të Dërguarin e Allahut, *sal-l’Allahu ‘alejhi ue sel-lem*, befaz, para nesh u duk një njeri me rroba shumë të bardha dhe flokë shumë të zinj. Në të nuk dukej asnjë gjurmë udhëtimi dhe asnjëri prej nesh nuk e njihte. Ai u ul pranë Pejgamberit, *sal-l’Allahu ‘alejhi ue sel-lem*, mbështeti gjunjë e vet mbi gjunjë e tij, vendosi duart në kofshët e tij dhe tha: “O Muhamed, më trego çfarë është Islami.”

I Dërguari i Allahut, *sal-l’Allahu ‘alejhi ue sel-lem*, tha:

إِسْلَامٌ أَنْ تَشْهَدَ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَأَنَّ مُحَمَّدًا رَسُولُ اللَّهِ، وَتَقِيمَ الصَّلَاةَ، وَتُؤْتِيَ الزَّكَاةَ، وَتَصُومَ رَمَضَانَ، وَتَحُجَّ الْبَيْتَ إِنْ اسْتَطَعْتَ إِلَيْهِ سَبِيلًا.

“Islami është: të dëshmosh se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përpos Allahu dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut,

të falësh namazin, të japësh zekatin, të agjërosh muajin e Ramadanit, dhe të bësh Haxhin në Shtëpinë e Shenjtë nëse ke mundësi."

Kurse ai tha: "Të vërtetën the."

Ne u çuditëm me të; ai e pyeste dhe pastaj e vërtetonte. Ai tha: "Më trego çfarë është Imani."

Ai u përgjigj:

أَنْ تُؤْمِنَ بِاللَّهِ وَمَلَائِكَتِهِ وَكُتُبِهِ وَرُسُلِهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ، وَتُؤْمِنَ بِالْقَدْرِ خَيْرِهِ وَشَرِّهِ.

"(Imani është) të besosh Allahun, Ëngjëjt e Tij, Librat e Tij, të Dërguarit e Tij, Ditën e Fundit dhe Kaderin (paracaktimin), të mirën dhe të keqen e tij."

Ai tha: "Të vërtetën the."

Pastaj i tha: "Më trego çfarë është Ihsani?"

Ai u përgjigj:

أَنْ تَعْبُدَ اللَّهَ كَأَنَّكَ تَرَاهُ، فَإِنْ لَمْ تُكُنْ تَرَاهُ فَإِنَّهُ يَرَاكَ.

"(Ihsani është) ta adhurosh Allahun sikur po e shikon Atë, por edhe pse ti nuk e shikon Atë, s'ka dyshim se Ai të shikon ty."

Ai tha: "Më trego për Orën e Fundit."

مَا الْمَسْئُولُ عَنْهَا بِأَعْلَمَ مِنَ السَّائِلِ.

Ai tha: "I pyeturi nuk di më shumë se ai që po pyet."

Atëherë ai tha:

أَنْ تَلِدَ الْأُمَمُ رَبَّتَهَا، وَأَنْ تَرَى الْحَفَاةَ الْعُرَاةَ الْعَالَةَ رِعَاءَ الشَّاءِ يَتَطَاوَلُونَ فِي الْبُنْيَانِ.

"Kur robëresha të lindë padronen e saj; kur t'i shohësh barinj të e dhenve, këmbëzbathur, të zhveshur e varfanjakë që garojnë me njëri-tjetrin në ndërtimin e godinave të larta."

Pastaj njeriu u largua, kurse unë ndenja për pak çaste. Ætëherë ai (i Dërguari i Allahut) tha:

يَا عُمَرُ أَتُنْرِي مَنْ السَّائِلُ؟

"O Umer, a e di kush ishte pyetësi?" Unë u përgjigja: "Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri." Ai tha:

فَأِنَّهُ جِبْرِيلُ أَتَاكُمْ يُعَلِّمُكُمْ دِينَكُمْ.

"Ai ishte Xhibrili. Erdhi t'ua mësojë Fenë tuaj."

Parimi i Tretë⁵⁸: që të njihni pejgamberin tuaj, Muhamedin (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*)

Dhe ai është Muhamedi,⁵⁹ i biri i 'Abdullahut, i biri i 'Abdul-Mutalibit, i biri i Hashimit, kurse Hashimi është nga Kurejshët.

⁵⁸ Dhe ky është parimi i tretë, që është: njohja e Pejgamberit tonë, Muhamedit (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*). Pra, njeriu e ka obligim që të njohë Pejgamberin e tij, të cilin ia dërgoi Allahu; dhe ai e përcolli Mesazhin, ia sqaroi atij ligjet që ia ka urdhëruar Allahu dhe ia bëri të qartë adhurimin për të cilin na krijoi Allahu.

⁵⁹ Ky Pejgamber është Muhamedi (*'alejhissalatu ues-salam*), Vula e Pejgamberëve dhe i Dërguari i Allahut për këtë Umet, për xhindët dhe për njerëzit. Atë e dërgoi Allahu për të gjithë njerëzimin. Ka thënë i Lartësuar: **"Thuaj (o Muhamed): O ju njerëz, me të vërtetë unë jam i Dërguari i Allahut për të gjithë ju."** [el-E'araf, 158] Dhe ka thënë i Përsosuri nga çdo e metë: **"Ne të kemi dërguar ty (o Muhamed) vetëm si përgëzues dhe paralajmërues për të gjithë njerëzimin."** [Sebe'e, 28] Pra, emri i tij është Muhamed, është gjithashtu Ahmed, është gjithashtu el-Hashir dhe el-Mukfij, ngase ai është Vula e Pejgamberëve, ai është Pejgamberi i pendimit, është Pejgamberi i mëshirës dhe i luftës. Të gjitha këto janë emrat e tij (*'alejhissalatu ues-salam*), mirëpo emri i tij më i famshëm, më i mirë e më i lartë është Muhamed, me të cilin e ka quajtur familja e tij dhe që ka ardhur në Kur'an. Ka thënë i Lartësuar: **"Muhamedi është i Dërguari i Allahut..."** [el-Fet'h, 6] I tillë është edhe emri tjetër i tij, Ahmed, sikurse ka përgëzuar 'Ijja (*'alejhissalam*) për ardhjen e tij: **"...dhe për t'ju sjellë lajmin e gëzueshëm për një të dërguar, emri i të cilit është Ahmed."** [es-Saff, 6] Pra, ai është Muhamedi, emri i babait të tij është 'Abdullah, emri i i gjyshit të tij është 'Abdul-Muttalib, dhe kjo është nofka e tij sepse emri i tij i vërtetë është Shejbeh, kurse emri i babait të gjyshit të tij është Hashim, dhe ai është një prej fisnikëve të Kurejshëve, sikurse 'Abdul-Muttalibi. Hashimi është prej Kurejshëve, dhe ata janë një fis i madh dhe më të mirët nga të gjithë Arabët. Kurse Pejgamberi (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*) është më i dalluari nga Benij Hashim, kurse Benij Hashim janë më të mirët nga Kurejshët. Emri i Kurejshit është Fehr Ibn Malik, dhe

Kurejshët janë nga Arabët dhe Arabët janë nga pasardhësit e Isma'ilit, i cili është i biri i Ibrahimit. Kurse Ibrahimit është miku (el-Khaliil) i Allahut, mbi të dhe mbi Pejgamberin tonë qofshin lavdërimet dhe bekimet më të mira.

Ai jetoi 63 vjet, prej të cilave 40 vjet i kaloi përpara pejgamberisë dhe 23 vjet si pejgamber dhe i dërguar. U bë pejgamber me suren "Ikra"⁶⁰ dhe u bë i dërguar me suren "el-Muddethir". Vendlindja e tij është Mekkah, por më pas ai u shpërngul në Medineh.

Allahu e dërgoi atë që të paralajmërojë kundër shirkut dhe që të thërrasë në Teuhid.

Dhe argumenti është Fjala e të Cartësuarit:

﴿يٰٓاَيُّهَا الْمُدَّثِّرُ ﴿١﴾ قُمْ فَأَنْذِرْ ﴿٢﴾ وَرَبِّكَ فَكَبِّرْ ﴿٣﴾ وَتَبٰٓءَاكَ فَطَهِّرْ ﴿٤﴾ وَالرُّجْزَ فَاهْجُرْ ﴿٥﴾
﴿وَلَا تَمُنُّنَ تَسْتَكْبِرُ ﴿٦﴾ وَلِرَبِّكَ فَاصْبِرْ ﴿٧﴾﴾

"O ti, i mbështjellë (o Muhamed)! Çohu dhe paralajmëro! Dhe Zotin tënd madhëro! Dhe rrobat e tua pastroj! Dhe ndyrësirën

është thënë gjithashtu se Kurejshi është en-Nadr Ibn Kinaneh, gjyshi i Fehr Ibn Malik. Kurejshi është nga Arabët e arabizuar, ata të cilëve iu mësuara gjuha me gjuhën Arabe dhe kështu gjuha e tyre u bë Arabishtja e kulluar. Ata janë më Arabë sesa Kahtanët, prandaj thuhet se ata janë Arabët me prejardhje të pastër arabe dhe Arabët e arabizuar. Dhe Kurejshët janë pasardhësit e Isma'il Ibn Ibrahim el-Khaliil.

⁶⁰ Dhe ky është pejgamberi i madh, Muhamedi (*sallAllahu 'alejhi ue sellem*), i cili u bë pejgamber me suren "Ikra". Ajeti i parë që i zbriti atij ishte: "Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (gjithçka)." [el-Alak, 1] dhe me këtë ai u bë pejgamber, atëherë kur i erdhi Xhibrili teksa ai po rrinte në shpellë, në shpellën Hira', dhe i lexoi këtë sure.

braktisel Dhe mos jep gjë, me synimin që të marrësh më shumë Dhe për hir të Zotit tënd, duro! [el-Mudethir, 1-7]

Kuptimi i ajetit: **“Çohu dhe paralajmërol”** është që të paralajmërojë kundër shirkut dhe të thërrasë në Teuhid,

- **“Dhe Zotin tënd madhërojel”** – domethënë madhëroje me Teuhid.

- **“Dhe rrobat e tua pastrojil”** – domethënë pastroji veprat e tua nga shirku.

- **“Dhe ndyrësirën braktisel”** – ndyrësia (*er-rrixh*) janë idhujt.

- **“Braktise”** do të thotë lëre, distancohu nga ajo dhe nga ithtarët e saj (d.m.th. idhujtarët).

Ai vazhdoi të thërrasë në Teuhid për 10 vjet me radhë⁶¹, dhe mbas 10 viteve u ngrit lart në qiell dhe iu dha detyra e faljes së pesë namazeve. U fal në Mekkeh për tre vjet, dhe pastaj u urdhëruar që të bënte hixhret në Medineh.

Dhe hixhreti është shpërngulja nga vendi i shirkut për në vendin e Islamit. Hixhreti është obligim për këtë Umet, që Muslimanët të shpërngulen nga vendi i shirkut për në vendin e Islamit, dhe ai do të mbetet gjer në Orën e Fundit.

Dhe argumenti është Fjala e të Shtëruarit:

⁶¹ Ai vazhdoi kështu për dhjetë vjet, duke thirrur në Teuhid e duke paralajmëruar kundër shirkut, duke urdhëruar që të braktiset adhurimi për të tjerët në vend të Allahut të Përsosur nga çdo e metë, që të braktiset adhurimi i idhujve dhe i qenieve njerëzore, si dhe që të veçohet Allahu me adhurim, duke ia kushtuar vetëm Atij lutjet, zotimet, kurbanet dhe të gjitha llojet e tjera të adhurimit.

﴿إِنَّ الَّذِينَ تَوَفَّيْنَاهُمْ لَمْ تَلْبِسْكُمُ ظَالِمِي أَنفُسِهِمْ قَالُوا فِيمَ كُنْتُمْ قَالُوا كُنَّا مُسْتَضْعَفِينَ فِي الْأَرْضِ قَالُوا أَلَمْ نَكُنْ أَرْضَ اللَّهِ وَسِعَةً فَتُهَاجِرُوا فِيهَا فَأُولَئِكَ مَأْوَاهُمْ جَهَنَّمَ وَسَاءَتْ مَصِيرًا ﴿٩٧﴾ إِلَّا الْمُسْتَضْعَفِينَ مِنَ الرِّجَالِ وَالنِّسَاءِ وَالْوِلْدَانِ لَا يَسْتَطِيعُونَ حِيلَةً وَلَا يَتَدُونُ سَبِيلًا ﴿٩٨﴾ فَأُولَئِكَ عَسَى اللَّهُ أَنْ يَعْفُوَ عَنْهُمْ وَكَانَ اللَّهُ عَفُورًا غَفُورًا ﴿٩٩﴾﴾

"Kur engjëjt ua marrin shpirtat atyre që e kanë ngarkuar veten me zullume, u thonë: "Ku ishit?" Ata përgjigjen: "Ishim të pafuqishëm në Tokë". (MelaiKET) do t'u thonë: "A nuk qe Toka e Allahut e gjerë që të emigronit në të?" Këta janë ata (njerëz), vendbanimi i të cilëve është Xhehenemi; eh, sa i keq është ai vendbanim! Me përjashtim të meshkujve të pafuqishëm, grave dhe fëmijëve, të cilët nuk kanë as fuqinë e as mundësinë të drejtohen në rrugë, Allahu do t'i falë, se Allahu, me të vërtetë, është Shlyes dhe Falës i gjynaheve." [en-Nisa, 97-99]

Dhe Fjala e të ƒartësuarit:

﴿يَعِبَادِ الَّذِينَ ءَامَنُوا إِنَّ أَرْضِي وَسِعَةٌ فِرَائِي فَاَعْبُدُونِ ﴿٩٧﴾﴾

"O robërit e Mi, që keni besuar! Toka Imë është vërtet e gjerë, andaj më adhuronit vetëm Mual" [el-Ankebut, 56]

Ka thënë el-Begauij, Allahu i ƒartësuar pastë mëshirë për të: "Shkaku i zbritjes së këtij ajeti është për Muslimanët që ishin në Mekkeh, të cilët nuk emigruan. Allahu i thirri ata me emrin e Imanit."

Dhe argumenti për hixhretin nga Suneti është fjala e tij (sal-ƒAllahu 'alejhi ue sel-lem):

لا تنقطع الهجرة حتى تنقطع التوبة، و لا تنقطع التوبة حتى تطلع الشمس من مغربها.

"Nuk ndërpritet hixhreti derisa të ndërpritet teubeja, dhe nuk ndërpritet teubeja derisa të lindë Dielli nga perëndimi."

Dhe kur u vendos në Medine,⁶² ai u urdhërua me pjesën tjetër të ligjeve Islame, siç ishte zekati, agjërimi, haxhi, xhihad, ezani, urdhërimi i të mirës, ndalimi i të keqes, si dhe ligjet e tjera të

⁶² "Dhe kur u vendos në Medine, ai u urdhërua me pjesën tjetër të ligjeve Islame" – siç ishte zekati, agjërimi i Ramadanit, haxhi në Shtëpinë e Shenjtë, xhihad, urdhërimi i të mirës dhe ndalimi i të keqes, ngaqë Medina u bë toka e Islamit dhe ajo është kryeqyteti i pari i Muslimanëve. Prandaj ata u urdhëruan me këto gjëra, sepse ata kishin mundësi që të urdhëronin të mirën dhe të ndalonin të keqen. Dhe është prej mëshirës së Allahut 'Azze ue Xhel-le që i vonoi këto obligime derisa ai emigroi në Medine. Fillimisht, zekati u ligjërue në Mekkeh, siç ka thënë i Lartësuari në suren el-En'am, e cila është sure e shpallur në Mekkeh: "...dhe jepni atë që është detyrë në ditën e vjeljes së tyre!" [el-En'am, 141] Mirëpo përcaktimi i masave dhe vlerave monetare, detajeve dhe dispozitave të zekatit, të gjitha këto erdhën në Medine.

- Po kështu edhe agjërimi i Ramadanit; ai u ligjërue në vitin e dytë të Hixhretit.

- Po kështu edhe haxhi, i cili u ligjërue në vitin e nëntë ose të dhjetë të Hixhretit dhe Allahu zbriti për të ajetin: "Dhe për Allahun është vizita (për haxh) e Shtëpisë së Shenjtë, e cila është detyrë për çdo njeri që ka mundësi ta përballojë rrugën." - në suren Aali-Imran, e cila ka zbritur në Medine.

- Po kështu edhe xhihad, i cili u urdhërua në Medine. Në fillim u urdhërua që të bëhej xhihad kundër atyre që i luftonin dhe të mos sulmonin ata që nuk i sulmonin. Pastaj u urdhërua që të fillonin luftën kundër atyre dhe që të bënin xhihad kundër qafirave edhe nëse ata nuk e fillonin luftën. Kështu, fillimisht Muslimanët i thërrisnin dhe i udhëzonin ata për tek Allahu dhe ata ose do të pranonin ose përndryshe do të luftoheshin derisa t'i përgjigjeshin hakut, me përjashtim të Ithtarëve të Librit (Çifutët dhe të Krishterët), sepse atyre u pranohej pagesa e taksës (xhizja) për të jetuar në tokat e Muslimanëve. Pastaj Allahu ligjëroi për Mexhusët të njëjtin ligj, ose të pranonin Islamin ose të paguanin xhizjen. Kurse pjesa tjetër e qafirave ose të pranojnë Islamin ose do të përballen me shpatën, në varësi të fuqisë së Muslimanëve.

Islamit. Ai vazhdoi kështu për 10 vjet me radhë, e pastaj vdiq,⁶³ lavdërimet dhe bekimet qofshin mbi të, kurse feja e tij do të vazhdojë të mbetet. Dhe kjo është feja e tij. Nuk la mirësi pa e udhëzuar Umetin e tij tek ajo, dhe nuk la të keqe pa e paralajmëruar Umetin që të ruhen prej saj.

Dhe mirësia në të cilën udhëzoi ai është Teuhidi dhe gjithçka që Allahu e do dhe kënaqet prej saj.

Kurse e keqja nga e cila ai paralajmëroi është Shirkun dhe gjithçka që Allahu e urren dhe e ka refuzuar.

Allahu e dërgoi atë për të gjithë njerëzimin dhe Ai e bëri obligim bindjen ndaj tij për të gjithë xhindët dhe njerëzit.

Dhe argumenti është Fjala e të Lartësuarit:

﴿يَتَأْتِيهَا النَّاسُ إِلَى رَسُولِ اللَّهِ إِلَيْكُمْ جَمِيعًا﴾

“Thuaj (o Muhamed): O ju njerëz, me të vërtetë unë jam i Dërguari i Allahut për të gjithë ju.” [el-Ë'araf, 158]

Nëpërmjet tij Allahu e përsosi Fenë. Dhe argumenti është Fjala e të Lartësuarit:

⁶³ Pasi që Allahu e përsosi fenë nëpër tij, Ai e mori atë nga kjo dynja, dhjetë vjet mbas Hixhretit. Ka thënë Allahu i Lartësuar: “Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj.” Dhe ka thënë Allahu Xhelle ue 'Alaa: “Sigurisht që ti (o Muhamed) do të vdesësh një ditë e, sigurisht që edhe ata do të vdesin. Pastaj, në Ditën e Gjykimit, ju do të grindeni para Zotit tuaj!” [ez-Zumer, 30-31]

﴿الْيَوْمَ يَمِيسَ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْ دِينِكُمْ فَلَا تَحْشَوْهُمْ وَاَحْسَوْنَ الْيَوْمَ اَكْمَلْتُ لَكُمْ دِينَكُمْ
وَاطْمَنتُ عَلَيْكُمْ نِعْمَتِي وَرَضِيْتُ لَكُمْ الْاِسْلَامَ دِينًا﴾

"Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj." [el-Ma'ideh, 3]

Dhe argumenti që ai (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*) ka vdekur është Fjala e të Lartësuarit:

﴿إِنَّكَ مَيِّتٌ وَإِئْتَمُّونَ ﴿٣٠﴾ ثُمَّ إِنَّكُمْ يَوْمَ الْقِيَامَةِ عِنْدَ رَبِّكُمْ تَخْتَصِمُونَ ﴿٣١﴾﴾

"Sigurisht që ti (o Muhamed) do të vdesësh një ditë e, sigurisht që edhe ata do të vdesin. Pastaj, në Ditën e Gjykimit, ju do të grindeni para Zotit tuaj!" [ez-Zumer, 30-31]

Njerëzit nëse vdesin, do të ringjallen.⁶⁴ Dhe argumenti është Fjala e të Lartësuarit:

⁶⁴ "Njerëzit nëse vdesin, do të ringjallen" - sikurse ka thënë i Lartësuarit: "Allahu ju ka krijuar nga toka, ashtu si bimët, pastaj ju kthen tek ajo dhe prej saj sërish do t'ju nxjerrë." Dhe ka thënë i Përsosuri nga çdo e metë: "Mohuesit kujtojnë se nuk do të ringjallen kurrsesi. Thuaju: "Po, për Zotin tim, me siguri që do të ringjalleni e pastaj do të njoftoheni për atë ç'keni bërë!" Dhe kjo është e lehtë për Allahun." Dhe ka thënë i Përsosuri nga çdo e metë: "Allahut i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë, për t'i dënuar ata që bëjnë keq, sipas veprave të veta e, për t'i shpërblyer ata që bëjnë mirë, me shpërblimin më të mirë." Pra, ata do të merren në llogari dhe do të marrin shpërblimin e tyre Ditën e Kijametit. Atyre do t'u jepen librat e tyre (me veprat që kanë punuar) në të djathtën apo në të majtën e tyre. Ai që është i lumtur do t'i jepet libri nga e djathta e tij, kurse fatkeqit do t'i jepet libri nga e majta e tij. Të lumturit do t'i rëndojnë më shumë veprat e mira në peshore, ndërsa të veprat e mira të fakeqit do të jenë të lehta në peshore. Kurse gjynahqarët janë në rrezik. Ka të ngjarë që veprat e mira në peshoren e tyre të rëndohen nga teubeja (pendimi) apo nga falja e Allahut apo

﴿مِنْهَا خَلَقْنَاكُمْ وَفِيهَا نُعِيدُكُمْ وَمِنْهَا نُخْرِجُكُمْ تَارَةً أُخْرَى﴾

“Ne ju kemi krijuar prej tokës, aty do t’ju kthejmë dhe nga ajo do t’ju nxjerrim edhe një herë tjetër.” [Ta-Ha, 55]

Dhe Fjala e të ʿArtësuarit:

﴿وَاللَّهُ أَنْبَتَكُمْ مِنَ الْأَرْضِ نَبَاتًا ﴿٥٦﴾ ثُمَّ يُعِيدُكُمْ فِيهَا وَيُخْرِجُكُمْ إِخْرَاجًا ﴿٥٧﴾﴾

“Allahu ju ka krijuar nga toka, ashtu si bimët, pastaj ju kthen tek ajo dhe prej saj sërish do t’ju nxjerrë.” [Nuh, 17-18]

Dhe mbas ringjalljes ata do të japin llogari dhe do të shpërblehen në varësi të veprave të tyre. Dhe argumenti është Fjala e të ʿArtësuarit:

﴿وَلِلَّهِ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ لِيَجْزِيَ الَّذِينَ أَسْتَوُوا بِمَا عَمِلُوا﴾

﴿وَيَجْزِيَ الَّذِينَ أَحْسَنُوا بِالْحَسَنَى﴾

nga sevapet. Dhe ka të ngjarë që veprat e mira në peshoren e tyre të jenë të lehta dhe kështu ata do të jenë prej banorëve të Zjarrit dhe do të dënohen atje aq sa të dojë Allahu. Pastaj Allahu do t’i nxjerrë për shkak se ata kanë vdekur në Islam. Kështu që, detyra e çdokujt që e ka detyrë zbatimin e urdhërave të Sheriatit, qoftë xhind apo njeri, është që ruhet nga veprat e këqija, të mos heqë dorë nga teubeja dhe t’i përmbahet Islamit, ngase ai nuk e di se kur do t’i dalë shpirti. Prandaj Muslimani duhet të jetë sa më i zellshëm dhe i vendosur dhe të luftojë me veten e tij që t’i përmbahet hakut dhe të pendohet vazhdimisht me pendim të sinqertë nga të gjitha gjynahet, në mënyrë që, nëse i vjen çasti që të ndahet nga kjo jetë, ai do të jetë duke bërë vepra të mira dhe duke iu përmbajtur Islamit. Kështu, ai do të fitojë lumturinë dhe shpëtimin në Ditën e Kijametit.

“Allahut i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë, për t’i dënuar ata që bëjnë keq, sipas veprave të veta e, për t’i shpërblyer ata që bëjnë mirë, me shpërblimin më të mirë.” [en-Nexhm, 31]

Kush e mohon ringjalljen ka bërë kufër. Dhe argumenti është Fjala e të Shtësuarit:

﴿زَعَمَ الَّذِينَ كَفَرُوا أَنْ لَنْ يُبْعَثُوا قُلْ بَلَىٰ وَرَبِّي لَتُبْعَثُنَّ ثُمَّ لَتُنَبَّؤُنَّ بِمَا عَمِلْتُمْ

وَذَلِكَ عَلَىٰ اللَّهِ يَسِيرٌ ﴿٧﴾

“Mohuesit kujtojnë se nuk do të ringjallen kurrësi. Thuaju: “Po, për Zotin tim, me siguri që do të ringjalleni e pastaj do të njoftoheni për atë ç’keni bërë!” Dhe kjo është e lehtë për Allahun.” [et-Çegabun, 7]

Allahu i dërgoi⁶⁵ të gjithë të Dërguarit si përgëzues dhe si paralajmërues. Dhe argumenti është Fjala e të Shtësuarit:

⁶⁵ I Dërguari (*sallallahu ‘alejhi ue sellem*) erdhi për të gjithë njerëzimin, për xhindët dhe për njerëzit, sikurse ka thënë i Shtësuari: “Thuaj (o Muhamed): O ju njerëz, me të vërtetë unë jam i Dërguari i Allahut për të gjithë ju.” [el-E’araf, 158] Dhe ka thënë i Shtësuari: “Ne të kemi dërguar ty (o Muhamed) vetëm si përgëzues dhe paralajmërues për të gjithë njerëzimin.” [Sebe’ e, 28] Dhe ai është Vula e Pejgamberëve dhe mbas tij nuk ka pejgamber tjetër. Kështu pra, të gjithë të Dërguarit erdhën tek popujt e tyre si përgëzues e paralajmërues, që nga i pari i tyre e deri tek i fundit. Dhe i dërguari i parë ishte Nuhu, të cilin e dërgoi Allahu atëherë kur u shfaq shirku tek populli i tij. Përpara tij ka qenë Ademi, i cili ishte pejgamber, i dërguar dhe i ngarkuar me detyra, e dërgoi Allahu tek pasardhësit e tij që ata ta adhuronin Allahun me sheriatin që ua solli babai i tyre, Ademi (*‘alejhis-salatu ues-selam*). Ata vazhduan të jenë në Islam dhe t’i përmban ligjeve të tij derisa u shfaq shirku tek populli i Nuhut. Dhe kur u shfaq shirku tek populli i Nuhut, Allahu u dërgoi atyre Nuhun (*‘alejhis-salatu ues-selam*), dhe ai është i dërguari i parë për banorët e Tokës, mbas shfaqjes së shirkut. Dhe çdo populli Allahu i çoi të

﴿رُسُلًا مُّبَيِّنِينَ وَمُنذِرِينَ لِقَلَّ يُكُونُ لِلنَّاسِ عَلَى اللَّهِ حُجَّةٌ بَعْدَ الرُّسُلِ﴾

“Të dërguar që janë përgëzues dhe paralajmërues, në mënyrë që njerëzit të mos kenë ndonjë justifikim ndaj Allahut, pas ardhjes së të dërguarve.” [en-Nisa, 165]

I pari nga të dërguarit është Nuhu (*‘alejhis-selam*), kurse i fundit është Muhamedi (*sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem*).⁶⁶

dërguar. Popullit të Adit Allahu i çoi Hudin, pastaj Allahu çoi Salihun tek populli i Themudit, pastaj çoi Ibrahimin, Lutin dhe Shuajbin në një kohë të afërt me njëri-tjetrin, pastaj erdhën me radhë të dërguarit e tjerë. Midis tyre është Musai, Haruni, ‘Ijsa, Ejubi, Davudi, Sulejmani, e pastaj vargu i tyre u vulos me Muhamedin (*‘alejhis-salatu ues-selam*).

⁶⁶ Pastaj vargu i të Dërguarve u vulos me Muhamedin (*‘alejhis-salatu ues-selam*), dhe ai është vula e tyre, i fundit i tyre dhe më i miri prej tyre (*‘alejhis-salatu ues-selam*). Ka thënë Allahu *Xhel-le ue ‘Alaa*: “Të dërguar që janë përgëzues dhe paralajmërues, në mënyrë që njerëzit të mos kenë ndonjë justifikim ndaj Allahut, pas ardhjes së të dërguarve.” Dhe Fjala e Tij: “përgëzues” – domethënë: i përgëzojnë me Xhenet ata që u binden atyre (d.m.th. të Dërguarve). “dhe paralajmërues” – domethënë: i paralajmërojnë njerëzit nga të bërit shirk Allahut, i paralajmërojnë nga Zjarri dhe dënimi i dhembshëm, nëse ata kundërshtojnë urdhërin e Allahut. Po kështu edhe Muhamedi (*sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem*), të cilin Allahu e dërgoi si përgëzues dhe paralajmërues, sikurse ka thënë i Lartësuari: “Ne të kemi dërguar ty si dëshmitar, si përgëzues dhe paralajmërues, si thirrës, që i fton njerëzit në rrugën e Allahut me urdhrin e Tij dhe si pishtar ndriçues.” [el-Ahzab, 45-46] Dhe ka thënë i Lartësuari: “Muhamedi nuk është babai i askujt prej burrave tuaj, por është i Dërguari i Allahut dhe Vula e Pejgamberëve.” [el-Ahzab, 40] Kështu që, detyra e të gjithë popujve është që ta pasojnë të Dërguarin e tyre. Pra, çdo popull e ka detyrë që të pasojë të Dërguarin e tij, që t’i nënshtrohet udhëzimit me të cilin erdhi ai. E me të vërtetë Allahu u ka premtuar atyre lumturinë në dynja e në Ahiret nëse u binden të Dërguarit të tyre, porse shumica e njerëzve nuk iu bindën të Dërguarit të tyre dhe e kundërshtuan

Dhe argumenti që i dërguari i parë ishte Nuhu (*alejhis-selam*) është Fjala e të Lartësuarit:

﴿إِنَّا أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ كَمَا أَوْحَيْنَا إِلَى نُوحٍ وَالنَّبِيِّينَ مِنْ بَعْدِهِ﴾

"Ne të kemi shpallur ty (o Muhamed), ashtu siç i kemi shpallur Nuhut dhe pejgamberëve pas tij." [en-Nisa', 163]

Çdo populli Allahi i ka dërguar të dërguar, që nga Nuhu e deri tek Muhamedi, të cilët i urdhëruan popujt e tyre që ta adhurojnë Allahun të vetëm⁶⁷ dhe i ndaluan nga adhurimi i Tagutëve.⁶⁸

udhëzimin që u sollën të Dërguarit. Ka thënë i Lartësuarit: "Shumica e njerëzve, sado që të mundohesh ti, nuk janë besimtarë." [Jusuf, 103] Dhe ka thënë i Lartësuarit: "E nëse i bindesh shumicës së njerëzve që janë në tokë, ata do të të devijojnë ty nga Rruga e Allahut." [el-En'am, 116] Dhe ka thënë i Lartësuarit: "Dhe pak nga robërit e Mi janë mirënjohës." [Sebe'e, 13] Dhe ka thënë i Lartësuarit: "Me të vërtetë, hamendja e Iblisit për ata u vërtetua; ata shkuan pas tij, përveç një grupi besimtarësh të vërtetë." [Sebe'e, 20]

⁶⁷ Dhe çdo i dërguar e thërriti popullin e tij në Teuhidin e Allahut, në bindjen ndaj Tij, që të heqin dorë nga të bërit shirk Atij dhe nga mosbindja ndaj urdhërave të Tij. Ka thënë i Lartësuarit: "Me të vërtetë Ne kemi çuar tek çdo popull të dërguar (që t'u thonin): Adhuroni Allahun dhe largohuni nga Tagutët." "Adhuroni Allahun" - domethënë: bindjuni Atij dhe veçojeni Atë, përmbajuni fesë së Tij dhe qëndroni larg Tagutëve.

⁶⁸ Taguti është çdokush që adhurohet në vend të Allahut dhe është i kënaqur që adhurohet, si dhe çdokush që nuk gjykon me ligjet që ka zbritur Allahut dhe bën thirrje që të mos gjykohet me to.

Gjithashtu, Taguti është ai që i kalon kufijtë ose me shirkun e tij ose me kufrin e tij ose me thirrjen e tij për shirk e kufër. Taguti më i keq dhe koka e të gjithë tagutëve është Iblisi, mallkimi i Allahut qoftë mbi të, e mbas tij vjen çdokush që thërret që të adhurohet në vend të Allahut dhe është i kënaqur që adhurohet në vend të Allahut, siç është Faraoni dhe Nemrudi; ose ai që pretendon se ka dije rreth Gajbit, siç janë falkxorët, falltarët dhe magjistarët në Xhahilijet, përpara Islamit. Gjithashtu, është edhe ai që me vullnetin e tij gjykon me ligje të cilat nuk i ka zbritur Allahu. Pra, ata janë kokat e tagutëve. Dhe çdokush që kalon kufirin dhe del nga bindja e Allahut quhet tagut. Ka

thënë i Lartësuar: **"S'ka detyrim në fe, sepse tashmë është dalluar e drejta nga e shtrembra!"** "E drejta" është Islami dhe ajo me të cilën erdhi Pejgamberi (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*). Kurse "e shtrembra" është kufri, mohimi i Allahut, si dhe devijimi. Ka thënë i Lartësuar: **"S'ka detyrim në fe, sepse tashmë është dalluar e drejta nga e shtrembra! Ai që mohon tagutët dhe beson Allahun është kapur në lidhjen më të fortë e cila nuk këputet kurrë. Dhe Allahu është Gjithëdhëgues dhe i Gjithëdhijshëm."**

- **"mohon tagutin"** - domethënë: distancohet nga taguti dhe beson se ai është i pavlerë, i kotë, si dhe distancohet nga shirkun.

- **"dhe beson Allahun"** - domethënë: të besojë se Allahu është i Adhuruari i tij i vërtetë dhe me hak, si dhe të besojë në Sheriatin e tij, të besojë Muhamedin (*'alejhis-salatu ues-selam*) dhe t'i nënshtrohet këtij besimi. Ky është besimtari.

- **"është kapur"** - domethënë: është mbajtur fort.

- **"në lidhjen më të fortë"** - që është: **La ilahe il-Allah**, fjala e Teuhidit.

Domethënë, ai është kapur fort në lidhjen e cila nuk këputet kurrë. Madje, kush kapet fort në të me vërtetësi dhe i qëndron besnik asaj, ai ka arritur Xhenetin dhe lavdinë, ngase kjo lidhje ka të drejtat e saj, të cilat janë: Teuhidi i Allahut, bindja ndaj Tij dhe pasimi i Sheriatit të Tij. Kurse Muhamedi (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*) është Vula e Pejgamberëve dhe e të Dërguarve, dhe ai është i Dërguari i Allahut për të gjithë banorët e tokës, xhindë dhe njerëz. Kështu që, është obligim për të gjithë ata që t'i binden atij dhe ta ndjekin Sheriatin e tij, dhe nuk i lejohet askujt që të dalë nga Sheriati i tij. Kurse të gjitha shariatet e mëparëshme janë shfuqizuar nga Sheriati i Muhamedit (*'alejhis-salatu ues-selam*), sikurse ka thënë i Lartësuar: **"Thuaj (o Muhamed): "O njerëz, unë jam i Dërguari i Allahut për të gjithë ju."** [el-E'araf, 158] Dhe ka thënë i Lartësuar përpara këtij ajeti: **"Prandaj, ata që do ta besojnë, nderojnë dhe përkrahin atë, duke ndjekur dritën që është zbritur me të, pikërisht ata janë të fituarit."** [el-E'araf, 157] Dhe ka thënë i Dërguari (*'alejhis-salatu ues-selam*) në hadithin e saktë: **"Betohem në Atë, në Dorën e të Cilit është shpirti im, çdokush nga ky Umet që dëgjon për mua, si dhe çdo Çifut e i Krishter, pastaj vdes pa besuar në shpalljen me të cilën u dërgova unë, ai do të jetë prej banorëve të Zjarrit."** E ka transmetuar Muslimi në Sahihun e tij. Ajetet dhe hadithet rreth kësaj çështjeje janë të shumta. Dijetarët, Allahu pastë mëshirë për ata, janë pajtuar të gjithë njëzëri se nuk i lejohet askujt nga ky Umet që të dalë nga Sheriati i Muhamedit (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*), dhe se kush beson se lejohet të dalësh nga Sheriati i tij, ai është kafir (mosbesimtar) me kufër të madh që të nxjerr nga feja. Allahu na dhëntë mirëqënie e na ruajt.

Dhe argumenti është Fjala e të ʿArtësuarit:

﴿وَلَقَدْ بَعَثْنَا فِي كُلِّ أُمَّةٍ رَسُولًا أَنِ اعْبُدُوا اللَّهَ وَاجْتَنِبُوا الطَّاغُوتَ ۗ﴾

“Me të vërtetë Ne kemi çuar tek çdo popull të dërguar (që t’u thonin): **Adhuroni Allahun dhe largohuni nga ʿTagutët.**” [en-Nahl, 36]

Allahu e bëri detyrë për të gjithë popujt që ta mohonin ʿTagutin dhe që të besonin Allahun.

Ka thënë Ibnul-Kajjim, Allahi i ʿArtësuar pastë mëshirë për të: “ʿTagut është: çdo gjë me të cilën robi kalon kufirin e tij, duke u adhuroar, duke u pasuar apo duke iu bindur atij.”

Dhe tagutët janë të shumtë, kurse kokat e tyre janë pesë:

- 1 – Ibli, mallkimi i Allahut qoftë mbi të.
- 2 – ai që adhurohet në vend të Allahut dhe është i kënaqur që adhurohet.
- 3 – ai që u bën thirrje njerëzve që të adhurohet vetja e tij.
- 4 – ai që pretendon se posedon diçka nga dija e Sajbit (e ʿFshehta të cilën e di vetëm Allahi).
- 5 – ai që gjykon me ligjet të cilat nuk i ka zbritur Allahi.

Dhe argumenti është Fjala e të ʿArtësuarit:

﴿لَا إِكْرَاهَ فِي الدِّينِ ۗ قَدْ تَبَيَّنَ الرُّشْدُ مِنَ الْغَيِّ ۚ فَمَنْ يَكْفُرْ بِالطَّاغُوتِ وَيُؤْمِرْ بِاللَّهِ فَقَدِ اسْتَمْسَكَ بِالْعُرْوَةِ الْوُثْقَىٰ﴾

“S’ka detyrim në fe, sepse tashmë është dalluar e drejta nga e shtrembral Ai që mohon tagutët dhe beson Allahun është kapur në lidhjen më të fortë.” [el-Bekarah, 250]

Dhe ky është kuptimi i fjalës *La ilahe il-Allah*.

Kurse në hadith ka ardhur:

رأس الأمر الإسلام، و عموده الصلاة، و ذروة سنامه الجهاد في سبيل الله.

“Koka e çështjes është Islami, shtylla e saj është namazi kurse kulmi i saj është xhibadi në Rrugë të Allahut.”⁶⁰

Dhe Allahu e di më së miri.

Çavdërimet dhe bekimet e Allahut qofshin mbi Muhamedin, si dhe mbi Familjen e tij dhe Shokët e tij.

Përktheu: Alban Malaj

E Enjte, 25 Rabij’ eth-Thanij 1424 Hixhrij / 07.03.2013 Miladij

‘Auali, Mekkeh

⁶⁰ Kurse në hadith ka ardhur: **“Koka e çështjes është Islami, shtylla e saj është namazi kurse kulmi i saj është xhibadi në Rrugë të Allahut.”**

Pra, detyra e të gjithë xhindëve dhe njerëzve është që ta veçojnë Allahun dhe ta adhurojnë Atë të vetëm e asgjë tjetër pos Tij, të mohojnë tagutin dhe ta refuzojnë adhurimin e tij, të kapen fort mbas Teuhidit, të ndjekin Sheriatin e Allahut *Subhanehu ue Te’ala* dhe t’i madhërojnë urdhëresat dhe ndalesat e Tij.

- “Koka e çështjes” domethënë, koka e fesë është Islami, domethënë është dëshmia “*La ilahe ilAllah, Muhammedun Rasulullah*”. Dhe kush i përmbahet kësaj dëshmie hyn në Islam.

- “shtylla e saj është namazi” dhe ai është shtylla e dytë dhe është shtylla më e madhe mbas dy dëshmimeve. Mbas namazit vjen zekati, agjërimi, haxhi dhe pjesa tjetër e urdhërave të Allahut.

- “dhe kulmi i saj është xhibadi në Rrugë të Allahut” sepse me të ruhet dhe mbrohet feja, me të thirren njerëzit në fenë e Allahut dhe detyrohen që të kapen pas të vërtetës. Prandaj ai është kulmi i Islamit, ngaqë ai përmban mbrojtjen e fesë dhe thirrjen në të vërtetën.



Përgaditi: Jsmet Hyseni